



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 130

Tiranë – E hënë, 22 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 110, datë 4.6.2026	Për përcaktimin e rregullave për administrimin e të dhënave të grumbulluara në zbatim të ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror..... 12009
Urdhër i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 270, datë 12.6.2026	Për miratimin e planit të veprimit me masa për të siguruar progres, që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI..... 12012
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 519, datë 11.6.2026	Për zëvendësimin e përkohshëm për nënshkrimin e dokumenteve në emër të Sekretarit të Përgjithshëm..... 12027
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 628, datë 11.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë..... 12027
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 629, datë 11.6.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 770, datë 6.8.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Spanjës” 12029
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 631, datë 12.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë 12029
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 632, datë 12.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë..... 12031

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 633, datë 12.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	12033
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3073/2, datë 15.6.2026	Për hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	12035
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 161, datë 5.6.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.....	12035
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 162, datë 5.6.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw”, i ndryshuar.....	12037
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 163, datë 5.6.2026	Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 199, datë 15.8.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘Procredit Bank’ sh.a.”.....	12039
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 164, datë 5.6.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “InfoTelecom-Albsolar 4” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	12040
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 165, datë 5.6.2026	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.....	12043
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 702/8, datë 16.6.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të qytetit të Vlorës”...	12047
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ylli Shullani.....	12047



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 110, datë 4.6.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE
TË GRUMBULLUARA NË ZBATIM TË
LIGJIT PËR KONTROLLIN E KUFIRIT
SHTETËROR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 32, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. Roja Kufitare, në funksion të kontrollit kufitar dhe vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në legjislacionin për kontrollin e kufirit shtetëror, mbledh dhe përpunon kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale:

a) të dhënat e identitetit dhe dokumentit të udhëtimit;

b) të dhënat biometrike, përfshirë të dhënat e identifikimit të mbledhura nga sisteme automatike të verifikimit kufitar;

c) të dhënat për udhëtimin, dokumentacionin mbështetës dhe lëvizjet ndërkufitare;

ç) të dhënat për informacionin paraprak për pasagjerin (API);

d) të dhënat mbi mjetet e transportit dhe sendet, kur këto janë të nevojshme për kontrollin kufitar;

dh) të dhënat për sigurinë dhe riskun, përfshirë të dhëna nga regjistra dhe baza të dhënash kombëtare e ndërkombëtare;

e) të dhënat financiare dhe administrative, përfshirë mjetet financiare të disponueshme;

ë) të dhënat për qarkullimin lokal kufitar;

f) të dhënat të regjistruara në sistemet e përpunimit, ku Policia Kufitare autorizohet të përdorë të dhëna për kërkime dhe menaxhim sigurie, si dhe t’ua transmetojë autoriteteve të tjera ligjzbatuese në rast dyshimi për veprë penale.

2. Roja kufitare, në funksion të kontrollit kufitar, përpunon të dhëna personale, në përputhje me parimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, vetëm në masën e nevojshme dhe

proporcionale për realizimin e një kontrolli kufitar sa më efektiv. Ky përpunim kryhet me qëllim garantimin e sigurisë kufitare dhe sigurisë së brendshme, si dhe për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

3. Roja kufitare, në përputhje me pikën 1, mbledh dhe regjistron të dhëna personale të:

a) shtetasve të huaj të refuzuar në hyrje të Republikës së Shqipërisë;

b) personave të refuzuar në dalje të Republikës së Shqipërisë;

c) shtetasve të huaj, të cilëve në zbatim të pikës 4, të nenit 17, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, nuk u vendoset vulë në dokumentin e udhëtimit;

ç) shtetasve të huaj që pajisen me vizë në kufi;

d) personave që pajisen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, ose që kalojnë kufirin, me dokumente që zëvendësojnë dokumentet e udhëtimit dhe vizat;

dh) personave të kthyer dhe të riatdhesuar nga autoritetet e huaja në Republikën e Shqipërisë, ose nga autoritetet shqiptare drejt një vendi tjetër;

e) personave që kanë kaluar ose tentojnë të kalojnë në mënyrë të paligjshme kufirin shtetëror;

ë) personave që paraqesin kërkesa dhe ankesa në kuptim të kontrollit kufitar;

f) personave që kryejnë kundërvajtje administrative nën juridiksionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit;

g) personave që kryejnë vepra penale nën juridiksionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit;

gj) personave që hyjnë dhe dalin në kufi, kur instrumentet elektronike ose arkivi elektronik i regjistrimit të hyrje-daljeve është jashtë funksionit për një kohë të gjatë, duke i depozituar të dhënat në një regjistër të përkohshëm shkresor.

4. Roja kufitare, në përputhje me pikën 1, mbledh dhe regjistron dokumentacion që përmban të dhëna personale, si më poshtë:

a) formularët e intervistimit të personave të kthyer dhe riatdhesuar në Shqipëri, si dhe të personave që kanë kaluar, apo tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt, kur këto janë të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe shkeljeve administrative apo identifikimin e viktimës /viktimave të mundshme të trafikimit;

b) dokumentacion mbështetës për kalimin e kufirit, të tilla si certifikata, ftesa, deklarata noteriale, kontrata etj.;



c) origjinalin ose kopjet e listave të udhëtarëve të mjeteve të transportit që kanë detyrim plotësimin dhe paraqitjen e këtyre listave;

ç) foto dhe video të siguruar me anë të pajisjeve të kontrollit kufitar, kur këto pajisje e mundësojnë këtë manualisht ose automatikisht dhe të dhënat në fjalë janë të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve administrative, apo për identifikimin e viktimës/viktimave të mundshme të trafikimit;

d) foto dhe video nga kamerat e sigurisë dhe pajisjet e tjera që janë instaluar në ambientet e përdorura nga Policia Kufitare dhe Migracionit për efekt të kontrollit kufitar.

5. Roja kufitare, për efekt të kontrollit kufitar, krahas të dhënave personale dhe dokumentacionit të parashikuar në pikat 3 dhe 4, të këtij udhëzimi, konsultojnë dhe shfrytëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm që përmban të dhëna personale:

a) shënimet, njoftimet dhe informacionet e autoriteteve ligjbatuese, të shfaqura automatikisht ose me kërkim në sistemet elektronike, si dhe ato që mbërrijnë në rrugë shkresore dhe që përcaktohen si të nevojshme të konsultohen dhe shfrytëzohen gjatë kontrollit kufitar;

b) arkiva elektronikë dhe shkresorë, që me marrëveshje, me ligj ose me vendim të autoriteteve përgjegjëse, përcaktohen si të nevojshme të konsultohen dhe shfrytëzohen gjatë kontrollit kufitar.

6. Regjistrimet për verifikimet e vijës së dytë dhe ato për identifikimin e viktimës/viktimave të mundshme të trafikimit, kryhen vetëm mbi bazë statistikore që nuk mundëson zbulimin e të dhënave personale të subjekteve. Rregullat praktike për këto raste përcaktohen me Procedura Standarde të Veprimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

7. Mbledhja, regjistrimi, konsultimi dhe shfrytëzimi i të dhënave të parashikuara në pikat 3 dhe 4, të këtij udhëzimi, si dhe konsultimi e shfrytëzimi i të dhënave të parashikuara në pikën 5, kryhet në mënyrë të tillë që roja kufitare që i mbledh, i regjistron, konsultohet me to dhe/ose i shfrytëzon, si dhe punonjësi autorizues, apo vendimmarrës, për këto veprime të rojës kufitare, të jetë i identifikueshëm.

8. Të gjitha regjistrimet që kryhen në arkiva shkresorë nga rojat kufitare mund të regjistrohen në arkiva elektronikë, kur është marrë një vendim për

krijimin e një arkivi të tillë nga autoritetet përgjegjëse.

9. Në rastet e parashikuara në pikën 8, arkivat shkresorë, të cilët regjistrohen në arkiva elektronikë, asgjësohen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga regjistrimi në arkiv elektronik. Arkivat e mëparshëm shkresorë, të cilët nuk regjistrohen ose nuk mund të regjistrohen në arkiva elektronikë, ruhen deri në afatin e parashikuar për anonimizim të pakthyeshëm, sipas përcaktimeve të pikës 13, apo fshihen sipas përcaktimit të pikës 14, të këtij udhëzimi.

10. Të dhënat e subjekteve të parashikuara në pikën 3, germa “gj”, regjistrohen detyrimisht në arkivin elektronik të hyrje-daljeve brenda 5 ditëve kalendarike nga rivendosja në funksion e sistemit kompjuterik ku regjistrohen këto të dhëna, ndërsa regjistri shkresor në fjalë asgjësohet brenda 7 ditëve kalendarike nga kalimi i të dhënave në arkiv elektronik.

11. Rregullimet praktike për marrjen e vendimit për regjistrim në regjistrë shkresor, mënyrën e këtij regjistrimi dhe mënyrën e kalimit në arkiv elektronik të të dhënave të parashikuara në pikën 3, germa “gj”, si dhe për mënyrën e asgjësimit të regjistrit shkresor përkatës, përcaktohen me Procedura Standarde të Veprimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

12. Gjatë dhe për efekt të kontrollit kufitar, roja kufitare konsultohet dhe shfrytëzon drejtpërdrejt të dhënat e lartpërmendura, në bazë të nevojës për njohje, sipas afateve në vijim:

a) 2 vjet për arkivin elektronik të hyrje-daljeve;

b) 1 vit për të dhënat e përmendura në pikën 3, gerrat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë” dhe “f”;

c) respektohen afatet e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale nr. 13, datë 21.1.2026, “Për mënyrën e organizimit, administrimit, afatit të ruajtjes, kontrollin dhe fshirjen e të dhënave të mbledhura në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personave”, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “g”;

ç) deri në kohën e asgjësimit të regjistrit, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “gj”;

d) 1 vit për të dhënat e përmendura në pikën 4, gerrat “a”, “b” dhe “c”;



dh) përgjatë gjithë kohës së memorizimit automatik ose manual, që ofron pajisja përkatëse për të dhënat e pikës 4, germa “ç” dhe “d”, por jo më shumë se 1 vit;

e) pa kufizim për shënimet dhe njoftimet aktive të parashikuara në pikën 5, germa “a”;

ë) 1 muaj pas anulimit, revokimit ose përfundimit të afatit të vlefshmërisë së shënimeve dhe njoftimeve të parashikuara në pikën 5, germa “a”;

f) përgjatë gjithë kohës së fuqisë ligjore të marrëveshjes, ligjit ose vendimit për aksesim, për të dhënat e parashikuara në pikën 5, germa “b”.

13. Të dhënat personale të përpunuara në mënyrë elektronike dhe manuale nga roja kufitare, në përputhje me pikat 3 dhe 4, anonimizohen në mënyrë të pakthyeshme, kur plotësojnë këto afate:

a) 2 vjet për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “a”, “b”, “ç”, “d”, “dh”, “e”;

b) 6 muaj për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “ë”;

c) për aq kohë sa parashikohet nga ligji për kundërvajtjet administrative, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “f”;

ç) 1 vit për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “c” dhe për të dhënat e parashikuara në pikën 4;

d) për aq kohë sa parashikohet në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale nr. 13, datë 21.1.2026, “Për mënyrën e organizimit, administrimit, afatit të ruajtjes, kontrollin dhe fshirjen e të dhënave të mbledhura në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personave”, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa “g”;

dh) 3 muaj pas përfundimit të afatit apo vlefshmërisë së veprimit të kërkuar në dokumentin shkresor, për të dhënat e parashikuara në pikën 5, germa “a”;

e) 5 vjet për hyrjet dhe daljet e regjistruara në arkiv elektronik.

14. Në rast se anonimizimi i pakthyeshëm, sipas përcaktimit në pikën 13, të këtij udhëzimi, rezulton teknikisht i parralizueshëm, të dhënat përkatëse i nënshtrohen fshirjes përfundimtare.

15. Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave në Policinë e Shtetit, bazuar në të drejtën për njohje që i jep legjislacioni ose marrëveshjet në fuqi, përcakton institucionet dhe

strukturat që aksesojnë dhe shfrytëzojnë drejtpërdrejt të dhënat e mbledhura dhe regjistruara nga rojat kufitare në arkivat elektronike, si dhe menaxhon përdoruesit.

16. Për rastet e çështjeve të veçanta, për të cilat një përdorues i caktuar kërkon, për shkak të detyrës, të aksesojë të dhënat përtej afatit të parashikuar të konsultimit dhe shfrytëzimit të drejtpërdrejtë për strukturën ku përdoruesi bën pjesë, kërkesa për akses, miratimi i saj, zbatimi dhe mbyllja e aksesit, përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

17. Policia Kufitare dhe e Migracionit vendos në dispozicion të autoriteteve të tjera të dhënat e mbledhura prej saj, në kuptim të nenit 32, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, vetëm në rast se këto të dhëna nuk mund të konsultohen dhe shfrytëzohen drejtpërdrejt nga autoriteti që i kërkon.

18. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron respektimin e rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim të përbashkët. Me qëllim verifikimit e përputhshmërisë së përpunimit të të dhënave personale me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo strukturë përgjegjëse që përpunon të dhëna personale, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim të përbashkët, me kërkesë të Komisionerit, i vendos në dispozicion të gjitha informacionet dhe regjistrimet e nevojshme.

19. Subjektet, të dhënat personale të të cilëve përpunohen nga roja kufitare në zbatim të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, gëzojnë të drejtat për informim, akses, korrigjim, fshirje ose kufizim të përpunimit, si dhe të drejtën për rishikimin e përgjigjes, sipas ligjit nr. 124/2024. Këto të drejta ushtrohen nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit, të përcaktuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

20. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin merr masat për zbatimin e afateve të parashikuara në këtë udhëzim për arkivat shkresorë.

21. Struktura përgjegjëse për Teknologjinë dhe Informacionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit merr masat për zbatimin e afateve të ruajtjes, aksesimit dhe anonimizimit të pakthyeshëm apo fshirjes së të dhënave personale që përpunohen në arkivat elektronike për efekt të kontrollit kufitar.



22. Udhëzimi i përbashkët nr. 515, datë 27.9.2016, “Për përpunimin e të dhënave personale nga rojat kufitare”, shfuqizohet.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

KOMISIONER PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

URDHËR
Nr. 270, datë 12.6.2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT ME MASA PËR TË
SIGURUAR PROGRES, QË SHQIPËRIA
TË KLASIFIKOHET SI NJË INOVATOR
MESATAR NË TABELËN EVROPIANE
TË REZULTATEVE TË INOVACIONIT,
ME REZULTAT NË PËRMIRËSIMIN E
RAPORTIMIT TË SHQIPËRISË PËR
TREGUESIT TEI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të VKM-së nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës ‘Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027’, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian ‘Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor’”; të urdhrit të Kryeministrit nr. 142, datë 29.8.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e një plani veprimi me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI, në kuadër të dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, si dhe bazuar rekomandimeve të Komisionit Evropian,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit, me rezultat në

përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Urdhri me nr. 179, datë 30.12.2025, “Për miratimin e planit të veprimit me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI” shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inovacionit dhe Teknologjisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, për koordinimin me të gjitha institucionet anëtare të grupit ndërinstitucional të punës të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e Planit të Veprimit, për zbatimin e masave që u përkasin sipas fushës së përgjegjësisë institucionale, si dhe për monitorimin e zbatimit të këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

BRIEF PAPER
**VLERËSIM I REZULTATEVE TË
EUROPEAN INNOVATION SCOREBOARD
2025**

**1. Analizë e pozicionimit të Shqipërisë në
European Innovation Scoreboard (EIS)**

European Innovation Scoreboard (EIS) është një raport vjetor i Bashkimit Evropian që shërben për të vlerësuar dhe krahasuar kapacitetin teknik dhe njerëzor të vendeve në kuadër të zhvillimit të inovacionit. Ky raport fokusohet në performancën e përgjithshme dhe funksionimin e sistemit kombëtar të inovacionit në tërësinë e tij.

Në përputhje me metodologjinë e *European Innovation Scoreboard (EIS)*, inovacioni vlerësohet si një proces i ndërlidhur politikash dhe kapacitetesh, i cili përfshin të gjithë ciklin e krijimit, zhvillimit dhe përdorimit të dijes; nga arsimi dhe aftësitë e kapitalit njerëzor, tek kërkimi shkencor, investimet në kërkim dhe zhvillim (K&Zh), si dhe aplikimin dhe matjen e impaktit konkret afatgjatë të rezultateve në ekonomi.

Sipas *European Innovation Scoreboard 2025*, Shqipëria renditet në vendin e 35-të ndër vendet e Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje, duke u klasifikuar në grupin e “*Emerging Innovators*”.



Performanca e përgjithshme e inovacionit ka shënuar një rritje prej 4.4% krahasuar me vitin 2024 dhe një rritje prej 7.4% krahasuar me vitin 2018, kështu duke reflektuar përmirësime të qëndrueshme në disa komponentë të sistemit kombëtar të inovacionit.

Raporti i *European Innovation Scoreboard* evidenton një profil të kombinuar të performancës së inovacionit në Shqipëri. Që nga viti 2018, Shqipëria ka regjistruar rritje të ndjeshme në një sërë treguesish kyç, veçanërisht në përqindjen e popullsisë që kanë ndjekur dhe kryer arsimin e lartë (indikatori 1.1.2), si dhe rritje të numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që prezantojnë risi në proceset e biznesit (indikatori 3.1.2). Paralelisht, është vërejtur edhe një përmirësim i produktivitetit të burimeve (indikatori 4.3.1).

Ndër pikat e forta për Shqipërinë në 2025 veçohen shitjet e inovacioneve të reja për tregun dhe për ndërmarrjen (indikatori 4.1.1), përqindja e NVM-ve që prezantojnë inovacione në produkte (indikatori 3.1.1), si dhe impakti mjedisor i produktivitetit të CO₂ bazuar në prodhim kombëtar (indikatori 4.3.2), dhe punësimin në ndërmarrje inovative (indikatori 4.1.2).

Pavarësisht vlerësimeve pozitive sa më sipër, raporti evidenton, gjithashtu, dobësi strukturore në disa tregues të rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të ekosistemit të inovacionit nga 2018 deri tani. Në veçanti, është shënuar një rënie e konsiderueshme në pjesëmarrjen e studentëve të huaj në programet e doktoraturës (indikatori 1.1.1), dhe në nivelin e bashkëpunimit inovativ të NVM-ve me aktorë të tjerë të ekosistemit (indikatori 3.2.1).

Në të njëjtën kohë, raporti për 2025-n identifikon dobësi të Shqipërisë në eksportet e produkteve me teknologji të mesme dhe të lartë (si, p.sh., kimikate organike, produkte farmaceutike, fije sintetike dhe artificiale, pajisje telekomunikacioni etj.) (indikatori 4.2.1), në eksportet e shërbimeve me intensitet të lartë njohurish (në transport detar, transport ajror, transport hapësinor etj.) (indikatori 4.2.2), në shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (K&Zh) në sektorin publik (indikatori 2.1.1), dhe bashkëpunimet shkencore publik-privat (indikatori 3.2.2), duke nënvizuar nevojën për forcimin e lidhjeve mes kërkimit shkencor dhe ekonomisë reale.

2. Vlerësimi i metodologjisë dhe të dhënave për raportimin e indikatorëve

Metodologjia e *European Innovation Scoreboard* (EIS) bazohet në një qasje të standardizuar krahasuese që mat performancën e inovacionit të vendeve përmes një grupi treguesish sasiorë dhe cilësorë. Ajo mbulon disa dimensione kryesore si kushtet kuadër, investimet, aktivitetet innovative dhe ndikimet.

Për Shqipërinë, aplikimi i kësaj metodologjie kërkon mbledhje sistematike të të dhënave të harmonizuara me standardet e BE-së, përfshirje institucionale ndërsektoriale dhe përshtatje të treguesve me kontekstin kombëtar, me synim orientimin e politikave publike drejt rritjes së kapaciteteve inovative dhe konkurrueshmërisë afatgjatë.

Të dhënat për indikatorët e raportuar për Shqipërinë në kuadër të *European Innovation Scoreboard* (EIS) mbledhen, përpunohen dhe llogariten nga INSTAT-i (Instituti i Statistikave). Për vitin 2025, Shqipëria ka raportuar për 25 nga 32 indikatorët që përfshihen në EIS.

Nga këta indikatorë, 13 bazohen në të dhëna të mbledhura përmes anketave statistikore të INSTAT-it, ndërsa indikatorët e tjerë raportohen nëpërmjet burimeve administrative. Për disa indikatorë specifikë, të dhënat përftohen drejtpërdrejt nga EUROSTAT-i ose OECD-ja.

Metodologjia e përdorur nga INSTAT-i, në anketat e përdorura, është e unifikuar me metodologjinë e *European Innovation Scoreboard*. Mbledhja e të dhënave realizohet përmes anketave kryesore si vijon:

- AFS (Anketa e Forcave të Punës), për indikatorët:
 - 1.1.2 Përqindja e popullsisë 25–34 vjeç me diplomë universitare;
 - 1.1.3 Përqindja e popullsisë 25–64 vjeç që ndjek mësim gjatë gjithë jetës;
 - 2.3.2 Përqindja e të punësuarve që janë specialistë në TIK.
- Vrojtimi TIK në familje, për indikatorët:
 - 1.3.2 Përqindja e individëve (mosha 16–74) me aftësi digjitale mbi nivelin bazë.
- Vrojtimi mbi K&Zh në Ndërmarrje, për indikatorët:
 - 2.1.1 Shpenzimet për K&Zh në sektorin qeveritar dhe universitar (si % e PBB);



- 2.2.1 Shpenzimet për kërkim dhe për zhvillim në sektorin privat (si % e PBB).

- Anketa e Inovacionit, për indikatorët:

- 2.2.2 Shpenzime për inovacion që nuk përfshijnë K&Zh (si % e xhiros);

- 3.1.1 Përqindja e NVM-ve që kanë prezantuar produkte të reja ose të përmirësuara për tregun ose për vetë kompaninë;

- 3.1.2 Përqindja e NVM-ve që kanë futur risi në procese (prodhim, menaxhim, logjistikë etj.);

- 3.2.1 NVM që kanë bashkëpunuar për inovacion me biznese ose institucione (si % e NMV);

- 4.1.1 Shitje nga produkte ose procese inovative si % e xhiros totale;

- 4.1.2 Numri i të punësuarve në ndërmarrje që kanë aktivitete inovative.

- Vrojtimi mbi TIK në ndërmarrje, për indikatorët:

- 2.3.1 *Cloud Computing*

Për sa u përket të dhënave mbi indikatorët që merren nga burime administrative, INSTAT-i bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me institucionet përkatëse përgjegjëse për grumbullimin e këtyre të dhënave. Procesi përfshin komunikimin zyrtar të institucioneve burimore, mbledhjen e të dhënave të administruara prej tyre, si dhe verifikimin dhe harmonizimin e informacionit të dërguar, në përputhje me standardet statistikore kombëtare dhe evropiane. Sipas INSTAT-it, institucionet që shërbejnë si burime administrative të të dhënave janë si më poshtë:

- Ministria e Arsimit, për indikatorët:

- 1.1.1 Numri i doktorëve të rinj në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë për 1000 banorë të moshës 25–34 vjeç;

- 1.2.3 Përqindja e studentëve të huaj të doktoraturës ndaj totalit të doktorantëve në vend.

- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për indikatorin:

- 1.3.1 Numri i familjeve që përdorin internet fikst me shpejtësi të paktën 100 Mb/s.

- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, për indikatorët:

- 3.3.1 Numri i aplikimeve për patenta ndërkombëtare (PCT) për çdo miliard PBB në PPS;

- 3.3.2 Numri i aplikimeve për marka tregtare për çdo miliard PBB në PPS;

- 3.3.3 Numri i aplikimeve për dizajne industriale për çdo miliard PBB në PPS.

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për indikatorin:

- 4.2.1 Eksporte të produkteve me teknologji të mesme dhe të lartë si përqindje e totalit të eksporteve të produkteve.

- Banka e Shqipërisë, për indikatorin:

- 4.2.2 Eksportet e shërbimeve me intensitet të lartë njohurish si përqindje e totalit të eksporteve të shërbimeve.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ Ministria e Bujqësisë/Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore/Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për indikatorin:

- 4.3.1 Produktiviteti i burimeve.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për indikatorin:

- 4.3.2 Produktiviteti i CO₂ bazuar në prodhim.

Gjatë analizimit të raportit *European Innovation Scoreboard 2025* dhe verifikimit të informacionit me INSTAT-in, është konstatuar se për disa indikatorë, megjithëse INSTAT-i ka raportuar të dhënat përkatëse brenda afateve të përcaktuara, në raportin përfundimtar të *European Innovation Scoreboard 2025*, këta indikatorë nuk janë përllogaritur mbi bazën e vlerave të raportuara nga INSTAT-i.

Kjo situatë sugjeron se, sipas vlerësimit të *European Innovation Scoreboard*, metodologjia e përdorur nga INSTAT-i për përllogaritjen e këtyre indikatorëve nuk konsiderohet plotësisht e përputhshme me metodologjinë e aplikuar nga EIS-ja.

Për sa më sipër, është vlerësuar se në nivel raportimi faktorët kyç që kanë diktuar rezultatet aktuale të performancës së Shqipërisë në *European Innovation Scoreboard* janë, si më poshtë:

- Mungesë raportimi të plotë: Boshllëqe në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore.

- Mospërputhje në metodologji: Mungesa e rakordimit metodologjik të përdorur nga INSTAT-i me metodologjinë e *European Innovation Scoreboard (EIS)*.

- Mungesë në parashikime ligjore për raportim në fusha interesi të caktuara sidomos lidhur me K&Zh dhe investimet financiare bashkëkohore dhe përkatëse.

3. Masat zbatuese për përmirësimin e situatës ekzistuese të Republikës së Shqipërisë

Plani i Veprimit i hartuar ka për qëllim përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në EIS, duke identifikuar dhe përshkruar në mënyrë të detajuar të gjitha masat konkrete, ndërhyrjet dhe nismat e



nevojshme, përfshirë, por pa u kufizuar, në ndërhyrjet në kuadrin ligjor, politikat sektoriale, masat administrative dhe institucionale.

Për të bashkërenduar punën në këtë drejtim, Plani i Veprimit përcakton prioritetet, detyrat konkrete dhe mekanizmat e koordinimit, me synimin e arritjes së rezultateve të matshme për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë dhe kalimin në grupin e “Moderate Innovators” deri në vitin 2027. Masat afatshkurtra prioritare, masat afatmesme konsoliduese, dhe masat afatgjata transformuese janë përmbledhur më poshtë, dhe listuar në mënyrë të detajuar në aneksin shoqërues.

Masat afatshkurtra (brenda vitit 2026): Ndërhyrje prioritare për raportim dhe strukturim

Masat afatshkurtra synojnë përmirësimin e shpejtë të indikatorëve ku Shqipëria paraqet performancë të ulët ose mungesë matjeje, në përputhje me objektivin strategjik 1 të SKSHTI 2023–2030: Forcimi i bazës së kapitalit njerëzor dhe kërkimit shkencor, si dhe me prioritetet horizontale të S3 për inovacion dhe transformim digjital. Indikatorë EIS që duhen adresuar drejtpërdrejt për të përmbushur masat afatshkurtra janë:

- 1.1.1, 1.1.3 – Burimet Njerëzore;
- 1.3.1, 1.3.2 – Digjitalizimi;
- 2.1.1 – Financë dhe mbështetje;
- 2.3.1, 2.3.2 – Investime në Teknologjinë e Informacionit.

Fokusi i masave:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për rrjetet e shpejtësisë së lartë/transpozimi i Rregullores së BE për Infrastrukturën Gigabit dhe investimi për mbulimin e zonave të bardha.

- Rritje e financimit publik për kërkimin shkencor, doktoraturat STEM dhe publikimet ndërkombëtare (SKSHTI – Programet Kombëtare të Kërkimit).

- Vendosje e instrumenteve fillestare të mbështetjes për inovacionin në biznese (grante për inovacion, kuponë digjitalë, mbështetje për *cloud computing*), në linjë me S3 – transformimi digjital i NVM-ve.

- Zgjerim i formimit profesional dhe certifikimeve në aftësi digjitale dhe ICT, në përputhje me SKSHTI – zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Masat afatmesme (2026–2028) Konsolidimi i ekosistemit të inovacionit dhe ndërkombëtarizimi

Masat afatmesme synojnë ndërtimin dhe konsolidimin e një ekosistemi funksional të inovacionit, duke forcuar lidhjet mes kërkimit shkencor, arsimit të lartë dhe sektorit privat, në përputhje me Objektivin Strategjik 2 të SKSHTI 2023–2030: Rritja e ndikimit të kërkimit dhe inovacionit në ekonomi, si dhe me prioritetet tematike të S3. Indikatorë EIS që duhen adresuar drejtpërdrejt për të përmbushur masat afatmesme janë:

- 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 – Sisteme kërkimore tërheqëse;
- 3.1.1, 3.1.2 – Inovatorët;
- 3.2.1, 3.2.2 – Bashkëpunimet;
- 3.3.1, 3.3.2, 3.3.3 – Pasuritë intelektuale.

Fokusi i masave:

- Forcimi i bashkëpunimit publik-privat në kërkim dhe inovacion, përmes projekteve të përbashkëta, publikimeve dhe transferimit të teknologjisë (SKSHTI – ndërlidhja kërkim-industri).

- Mbështetje për ndërkombëtarizimin e rezultateve kërkimore dhe produkteve inovative, përfshirë pjesëmarrjen në Horizon Europe, COST, Erasmus+, në linjë me S3 – orientimi drejt tregjeve ndërkombëtare.

- Forcimi i kapaciteteve për pronësinë intelektuale (patenta, marka, dizajn), në përputhje me SKSHTI – valorizimi i njohurive.

Masat afatgjata (2028–2030) Transformimi strukturor dhe qëndrueshmëria e sistemit të inovacionit

Masat afatgjata synojnë transformimin strukturor të sistemit kombëtar të inovacionit, duke siguruar që përmirësimet në EIS të jenë të qëndrueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë afatgjatë, në përputhje me objektivin strategjik 3 të SKSHTI 2023–2030 dhe vizionin afatgjatë të S3. Indikatorë EIS që duhen adresuar drejtpërdrejt për të përmbushur masat afatgjata janë:

- 4.3.1, 4.3.2 – Produktiviteti i burimeve dhe i punës.

Fokusi i masave:

- Integrimi i inovacionit, digjitalizimit dhe teknologjive të gjelbra në ekonomi, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit të burimeve dhe punës (S3 – tranzicioni i gjelbër dhe digjital).



4. Mekanizma për të forcuar koordinimin, menaxhimin e të dhënave dhe hartimin e politikave me qëllim përmirësimin e performancës në EIS.

Ky seksion përcakton hapat konkretë për forcimin e koordinimit ndërinstitucional, përmirësimin e raportimit statistikor, përafrimin e politikave me metodologjinë EIS dhe zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të hartimit të politikave të bazuar në të dhëna. Në këtë kontekst, objektivi është të adresohen boshllëqet ekzistuese bazë, të mundësohet zbatimi efektiv përmes objektivave të matshëm, të përmirësohen mekanizmat e ndarjes së burimeve dhe monitorimit, si dhe të forcohet lidhja midis masave të politikave dhe indikatorëve të EIS-së.

4.1 Mekanizmi i koordinimit dhe monitorimit

Zbatimi dhe ndjekja e Planit të Veprimit do të kryhet brenda kornizës ndërinstitucionale të përcaktuar me urdhrin nr. 142 të Kryeministrit, i cili krijoi grupin e punës ndërinstitucional përgjegjës për koordinimin e masave që lidhen me performancën e Shqipërisë në Tabelën Evropiane të Inovacionit, duke caktuar, gjithashtu, për secilin indikator, një pikë kontakti përgjegjëse nga institucioni përkatës.

Përfaqësuesit institucionalë të caktuar sipas kësaj kornize do të sigurojnë koordinim të rregullt teknik nën udhëheqjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë.

Për të forcuar zbatimin, monitorimin dhe raportimin, puna e grupit ndërinstitucional do të përfshijë:

- takime mujore të rishikimit teknik gjatë gjithë vitit 2026, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse dhe INSTAT-i, duke u përqendruar në plotësimin metodologjik, indikatorët që mungojnë dhe konsistencën e të dhënave; të ndjekura nga takime të rishikimit teknik të paktën çdo tre muaj gjatë vitit 2027;

- përgatitjen nga secili institucion përgjegjës të një raporti vjetor të zbatimit, që do t'i paraqitet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit brenda muajit shkurt të çdo viti, duke mbuluar progresin e zbatimit, statusin e indikatorëve, disponueshmërinë e të dhënave, çështjet metodologjike dhe hapat e mëtejshëm. Bazuar në këto raporte, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit do të përgatisë raportin

vjetor të konsoliduar të zbatimit brenda tremujorit të parë të çdo viti.

- shqyrtim teknik vjetor i progresit në lidhje me indikatorët që mungojnë, përafrimin metodologjik dhe zbatimin e masave të parashikuara sipas Planit të Veprimit.

4.2 Veprime prioritare për plotësimin metodologjik dhe indikatorët që mungojnë

Bazuar në konsultimet e fundit teknike me INSTAT-i dhe institucionet përgjegjëse, puna metodologjike prioritare gjatë vitit 2026 do të përqendrohet në plotësimin dhe përafrimin e raportimit për indikatorët që aktualisht nuk mbulohen plotësisht ose që kërkojnë përmirësim metodologjik sipas kërkesave të EIS-së.

Veprimet e mëposhtme metodologjike janë parashikuar për zbatim brenda vitit 2026 me qëllim përmirësimin e plotësisë së raportimit të EIS-së:

- 1.3.1 Aksesit në internet me shpejtësi të lartë, nëpërmjet harmonizimit metodologjik midis INSTAT-i, AKEP-i dhe institucioneve përkatëse të sektorit, bazuar në të dhënat administrative dhe përafrimin me përkufizimet e EIS-së;

- 2.2.3 Shpenzimet për inovacion për person të punësuar, nëpërmjet përpunimit të mëtejshëm metodologjik të të dhënave të *Community Innovation Survey (CIS)* të disponueshme për vitet 2022 dhe 2024;

- 4.2.3 Importet e teknologjisë së lartë nga jashtë BE27, nëpërmjet punës teknike ndërinstitucionale që përfshin statistikën tregtare, llogaritë kombëtare dhe burimet e të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Paralelisht, progresi i mëtejshëm do të kërkojë koordinim të forcuar midis INSTAT-it, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe të gjitha institucioneve që ofrojnë të dhëna administrative, me fokus të veçantë në indikatorët që aktualisht nuk janë mbuluar ende, me qëllim strukturimin progresiv të proceseve të mbledhjes së të dhënave dhe përmirësimin e disponueshmërisë së të dhënave.

Përpjekjet prioritare do të përfshijnë gjithashtu analizën e indikatorëve të mbetur që mungojnë dhe fizibilitetin e tyre për raportimin e ardhshëm, përmirësimin e plotësisë dhe konsistencës së të dhënave, zgjatjen e serive kohore për indikatorët ekzistues, përafrimin e mëtejshëm metodologjik me standardet EIS dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për mbledhjen, validimin dhe transmetimin në kohë të të dhënave.



Progresi në këto veprime do të ndiqet rregullisht përmes mekanizmit të koordinimit dhe monitorimit të krijuar sipas këtij Plan Veprimi, me qëllim sigurimin e rishikimit të vazhdueshëm teknik, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe identifikimit në kohë të sfidave metodologjike ose sfidave të lidhura me të dhënat.

4.3 Fokusi prioritar i zbatimit

Përveç masave që adresojnë plotësimin metodologjik dhe indikatorët që mungojnë, Plan i Veprimit përfshin ndërhyrje të synuara për indikatorët me potencial më të lartë përmirësimi afatshkurtër dhe afatmesëm, veçanërisht në fushat e burimeve njerëzore, sistemeve tërheqëse të kërkimit, digjitalizimit dhe mbështetjes publike për kërkimin dhe inovacionin.

Drejtoria e Përgjithshme e Inovacionit dhe Teknologjisë, në bashkëpunim ndërinstitucional, ka mbikëqyrur me rigorozitet shqyrtimin e masave ekzistuese, me objektivin kryesor të sigurimit të zbatimit të tyre efektiv përmes përcaktimit të aktiviteteve të qarta, të matshme dhe të monitorueshme.

Në këtë kontekst, Plan i Veprimit është përditësuar duke përfshirë aktivitete shoqëruese për masat, si dhe buxhetet përkatëse të nevojshme për të mundësuar zbatimin e tyre brenda një afati kohor të përcaktuar.

Përparësi do t'u jepet ndërhyrjeve që janë të realizueshme në afat të shkurtër dhe afatmesëm dhe që mund të monitorohen përmes strukturave ekzistuese institucionale, me qëllim sigurimin që ndikimi i gjeneruar nga zbatimi i masave të jetë i matshëm dhe në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të raportimit.

Vëmendje e veçantë u kushtohet indikatorëve që lidhen me të diplomuarit e doktoraturës në fushat STEM (1.1.1), botimet shkencore më të cituara (1.2.2), studentët e huaj të doktoraturës (1.2.3), aksesin në internet me shpejtësi të lartë (1.3.1), shpenzimet për inovacion për person të punësuar (2.2.3) dhe importet e teknologjisë së lartë nga jashtë BE-së-27 (4.2.3), ku koordinimi i synuar institucional, përmirësimet metodologjike dhe masat e përforcuara të zbatimit konsiderohen thelbësore për përmirësimin e performancës së Shqipërisë në Tabelën Evropiane të Inovacionit.

ANEKSI 2
TABELA E PLAN VEPRIMIT

Shtylla	Komponentët	Indikatorët	Masat	Aktiviteti	Buxheti (AL)	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor i masës
1. Kushtet kuadër	1.1 Burimet njerëzore	1.1.1 Numri i doktorëve të rinj në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë për 1000 banorë të moshës 25–34 vjeç	M1. Përmirësimi i akteve normative lidhur me përcaktimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor, duke vënë theksin në fushat dhe nënfushat e STEM-it	A1. Analizë e kuadrit ekzistues ligjor dhe strategjik: - Rishikimi i legjislacionit aktual për arsimin e lartë; - Rishikimi i akteve nënligjore për arsimin e lartë.	2,900,000	MA/AKKSHI	1. Drafti i parë i Ligjit për Arsimin e Lartë – deri në dhjetor 2026, MA 2. Aktet nënligjore – deri në dhjetor 2027, MA
				A2. Rishikimi i akteve nënligjore për kërkimin shkencor.	410,000		Deri në qershor 2026, MA
				A3. Rishikimi i strategjisë për Arsimin; - Identifikimi i boshllëqeve në lidhje me adresimin e fushave STEM.	725,000		Deri në dhjetor 2027, MA
				A4. Hartimi i listës së përditësuar të fushave dhe nënfushave prioritare STEM/ Kërkimit shkencor: - Harmonizim me S3; - Harmonizim me prioritetet e BE (FRASCAT) dhe programet si <i>Horizon Europe</i> .	2,400,000		Deri në dhjetor 2026, AKKSHI
				A5. Hartimi i një metodologjie të bazuar në evidencë që kombinon: a) të dhënat mbi kërkesën në tregun e punës; b) të dhënat mbi regjistrimin dhe përfundimin e studimeve të doktoraturës (PhD); dhe c) treguesit e performancës kërkimore (duke përdorur të dhëna nga <i>Scopus</i>).	4,200,000		Dhjetor 2027, AKKSHI



				Metodologjia duhet të rishikohet çdo 3 vjet dhe të publikohet.			
				A6. Ndërgjegjësim dhe komunikim publik: - Publikimi i dokumenteve prioritare; - Organizimi i <i>workshop</i> -eve me aktorët e sistemit akademik.	N/A		Në vijimësi
		M2. Prioritarizimi i financimit, në kuadër të Programit të Doktoratës i platformave doktorale në fushat STEM.	A1. Financimi i doktoraturave të aplikuara në fushat STEM. - Përcaktimi i kriterëve prioritare (impakt shkencor, bashkëpunim ndërkombëtar, lidhje me industrinë).	17,000,000	AKKSHI	Realizohet në çdo thirrje vjetore për aplikime të AKKSHI, me vendim të Bordit të Administrimit.	
			A2. Financimi i doktoraturave që zhvillohen si projekte të përbashkëta (<i>joint/ double degree</i>). - Partneritete me universitete evropiane. - Mbështetje për mobilitetin e doktorantëve.	7,250,000			
			A3. Përfshirja e sektorit privat në bashkëfinancim - Financimi me prioritet për doktoraturat që vijnë si projekt i përbashkët me sektorin e industrisë.	29,350,000			
			A4. Monitorim dhe vlerësim i performancës së programeve doktorale - Indikatorë për përfundimin në kohë, publikime, punësim. - Raportim vjetor i performancës.	7,200,000			
		M3. Prioritarizimi i financimit në kuadër të Programeve Kombëtare (PKKZH dhe PTI) i projektpropozimeve në fushat STEM, për t'ju krijuar mundësi studentëve doktoralë dhe atyre të masterit të angazhohen në kërkim shkencor.	A1. Përshtatja e kriterëve të vlerësimit për projektet - Prioritarizimi i përfshirjes së doktorantëve dhe studentëve master në Programet Kombëtare në STEM. - Financimi i të paktën 40% të projekteve të aplikuara në fushat STEM.	1,000,000	AKKSHI	Realizohet në çdo thirrje vjetore për aplikime të AKKSHI, me vendim të Bordit të Administrimit.	
			A2. Nxitja e bashkëpunimit universitet-industri - Projekte të përbashkëta me biznesin në fushat STEM.	2,500,000			
			A3. Monitorimi i përfshirjes së studentëve doktorantë në Programet Kombëtare. - Evidentimi i numrit të studentëve doktorantë të përfshirë.	800,000			
		M4. Të prioritarizohet financimi nga AKKSHI në kuadër të PIKSH, të infrastrukturave kërkimore - shkencore që i takojnë fushave STEM.	A1. Përcaktimi i prioritetëve investuese në infrastrukturë Fokus në laboratorë, pajisje dhe qendra ekselence në STEM.	550,000	AKKSHI	Realizohet në çdo thirrje vjetore për aplikime të AKKSHI, me vendim të Bordit të Administrimit.	
			A2. Financimi i projekteve për modernizim dhe ndërtim infrastrukturë - Thirrje të dedikuara në kuadër të PIKSHI. - Bashkëfinancim me fonde ndërkombëtare.	127,500,000			
			A3. Krijimi i mekanizmeve për akses të hapur (<i>open access</i>) - Platforma për përdorimin e përbashkët të pajisjeve. - Rregullore për akses nga universitete dhe industri.	1,250,000			
		M5. Të mbledhet Këshilli Kombëtar i Shkencës me qëllim përcaktimin e fushave prioritare.	A1. Përgatitja e bazës analitike për vendimarrje - Konsultime paraprake me grupet e interesit - Organizimi i mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Shkencës - Miratimi i fushave prioritare - Publikimi dhe shpërndarja e vendimit	1,900,000	Ministria e Arsimit	Dhjetor 2026	



				- Integrimi në instrumentet e financimit dhe politikat publike			
	1.1.2 Përqindja e popullsisë 25–34 vjeç me diplomë universitare	M1. Të rritet shumëllojshmëria e programeve akademike në vend nëpërmjet ndërkombëtarizimit të programeve universitare. Të paktën 3 marrëveshje të reja me universitete ndërkombëtare me diploma të dyfishta ose bashkëpunime të ngjashme.	A1. Përcaktimi i programeve akademike të IAL-ve që janë nën Fushën e Studimit Prioritar A2. Identifikoni IAL-të e BE-së që ofrojnë të njëjtat programe akademike nën Fushën e Studimit Prioritar A3. Takim me palët e interesuara dhe nënshkrimi i Marrëveshjes sipas së cilës IAL-të do të ofrojnë diploma të dyfishta ose do të bashkëpunojnë si partnerë me anë të lëvizshmërisë së ndërsjellë të stafit dhe studentëve në këto programe; - Miratimi i Marrëveshjes për Diplomën e Dyfishtë ose fushën e lëvizshmërisë; - Rinovimi i Marrëveshjes të jetë automatik.	19,300,000	Ministria e Arsimit	2026–2028	
		M2. Të profilizohen Institucionet e Arsimit të Lartë sipas fushave. Të paktën 3 profilizime.	A1. Analizimi i fushës akademike të IAL-së në vend në përputhje me regjistrimet e ofruara në këta 5 vjetët e fundit. - Përcaktimi i Fushave me Prioritet Ekonomik të IAL-së në qark dhe të ardhurat e saj të Brendshme në PBB. - Kategorizimi i 3 fushave akademike më të rëndësishme të IAL-së me ndikim ekonomik dhe dimensiononi i kurrikulat e tyre. - Profilizoni këto IAL sipas ndikimit të tyre ekonomik në rajon/qark/vend dhe regjistrimet në fushat e analizuar.	5,900,000	Ministria e Arsimit	2026–2028	
	1.1.3 Përqindja e popullsisë 25–64 vjeç që ndjek mësim gjatë gjithë jetës	M1. Të rritet në 20% numri i punëkërkuarve të papunë të regjistruar në databazën e AKPA-së që trajtohen me kurse të formimit profesional. M2. Të krijohen qendra shumëfunktionale në funksion të rritjes së numrit të ofruesve publik dhe shtrirjes territoriale të trajnimeve profesionale.	A1. Hartimi dhe miratimi i Treguesve të Monitorueshëm (KPI) të qendrave publike të formimit profesional. A2. Fushata ndërgjegjësimi për rritjen e numrit të regjistrimeve. A3. Ndjekja dhe monitorimi vjetor i ecurisë së regjistrimeve në kurse të punëkërkuarve të papunë përmes sistemit informatik	Buxheti vjetor i vitit 2026 është 435,000,000. Ky është buxheti total i qendrave të formimit profesional përmes të cilave sigurohet aktiviteti dhe përmbytja e objektivave vjetorë.	AKPA	Q2 2026 2026 Q2 2026	
			A1. Ofrimi i kurseve afatshkurtra përmes krijimit të qendrave të para shumëfunktionale.	4,615,154	AKPA	Q2 2027	
1.2 Sisteme kërkimore tërheqëse	1.2.1 Numri i publikimeve shkencore me bashkëautorë ndërkombëtarë për 1 milion banorë	M1. Ngritja dhe forcimi i qendrave kombëtare shkencore të ekselencës që integrojnë studiues dhe burime kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. M2. Krijimi i rrjeteve të kërkuesve shkencorë	A1. Identifikimi dhe përzgjedhja e fushave prioritare për qendrat e ekselencës. Analizë <i>benchmarking</i> me qendrat evropiane të ekselencës. Fokus në fusha me potencial të lartë bashkëpunimi ndërkombëtar. A2. Analizë e kuadrit ekzistues ligjor dhe draftimi i akteve nën ligjore për Qendrën e Ekselencës. - Draftimi i VKM për Qendrat e Ekselencës. A3. Rekrutimi i studiuesve ndërkombëtarë dhe diaspora Skema “ <i>visiting researchers</i> ” dhe “ <i>adjunct professors</i> ”. Kontrata afatshkurtra për ekspertë të huaj. A1. Përditësimi <i>Database-s</i> së kërkuesve shqiptarë	1,000,000 600,000 26,000,000 3,650,000	MA/AKKSHI AKKSHI	Dhjetor 2026 Dhjetor 2026 2026–2028 Dhjetor 2026	



			brenda dhe jashtë Shqipërisë.	brenda vendit dhe në diasporë, sipas fushave kërkimore dhe ekspertizës.			
				A2. Organizimi i konferencave dhe forumeve shkencore ndërkombëtare - Evente vjetore tematike në Shqipëri.	20,500,000		2026–2028
				A3. Krijimi i grupeve të kërkimit, Programi READ, Programi “Diaspora për Shkencën”; - Nxjtja e bashkëpunimeve për projekte të përbashkëta; - Angazhimi i studiuesve shqiptarë jashtë vendit si bashkautorë; - Mbështetje për projekte të përbashkëta Shqipëri–diasporë.	43,000,000		2026–2028
				A4. Nxjtja e bashkëpunimeve përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale, rrjeti EUREKA. - Skema të financimit për projekte të përbashkëta.	22,000,000		2026–2028
			M3. Rritja e numrit të kërkuesve shqiptarë që kanë përfutur nga programet e shkëmbimit /mobilitetit në kërkim.	A1. Mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në kuadër të programeve bilaterale. - Grant për prezantim punimesh. - Prioritet për publikime në revista me <i>impact factor</i> . - Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit bilateral në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit	42,500,000	AKKSHI	2026–2028
				A2. Zgjerimi i skemave të bursave për mobilitet ndërkombëtar, Programi CEEPUS. - Skema bashkëfinancimi për mobilitet të dyanshëm. - Bursë për kërkime afatshkurtra.	13,000,000		
				A3. Ndjekja e rezultateve të mobilitetit Matja e publikimeve që burojnë nga mobiliteti. Krijimi i një sistemi raportimi për impaktin shkencor.	1,000,000		
			M4. Rritja e numrit të kërkuesve shqiptarë pjesëmarrës në Projektet Ndërkombëtare si <i>Horizon Europe</i> apo <i>network-et</i> si COST.	A1. Forcimi i kapaciteteve për aplikim në projekte ndërkombëtare Horizon Europe. - Këshillimi i kërkuesve shkencorë dhe institucioneve kërkimore.	2,750,000	AKKSHI	2026–2028
				A2. Rishikimi dhe forcimi i strukturës kombëtare mbështetëse (<i>National Contact Points+</i>) - Shërbime këshillimore për aplikuesit. - Asistencë në identifikimin e partnerëve ndërkombëtarë. - Financim për takime me partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve ndërkombëtare ku AKKSHI aderon	7,000,000		
				A3. Promovimi i pjesëmarrjes në rrjetet COST dhe partneritete të tjera; - Rritja e pjesëmarrjes së kërkuesve deri në 95% të aksioneve të COST; - Mbështetje për organizimin e aktiviteteve COST në Shqipëri.	59,500,000		2026–2028
		1.2.2 Përqindja e publikimeve që bëjnë pjesë në 10% më të cituarat globalisht, mbi totalin e publikimeve të vendit	M1. Të rritet financimi i programeve kombëtare nga AKKSHI, që do të përmirësojë numrin e publikimeve në revista të huaja të indeksuara.	A1. Rishikimi i kritereve të financimit në programet kombëtare (PKKZH, PITI, PHD); - Rritja e financimit për publikime në revista me faktor të lartë impakti. -Mbështetje për studiues të rinj dhe doktorantë.	40,160,000	AKKSHI	2026–2028



				A2. Ndërtimi i një sistemi monitorimi të citueshmërisë Analizë bibliometrike e publikimeve kombëtare. Ndjekja e treguesve si <i>H-index, citations per paper, FWC</i> .	11,500,000		
			M2. Të indeksohen revistat kombëtare që botojnë IAL-të sipas kriterëve të përcaktuara në urdhrin nr. 36 datë 24.1 2023 “Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrin shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë”, për kategoritë e revistave brenda vendit.	A1. Këshillimi i kërkuarve shkencorë dhe zyra të projekteve në institucionet kërkimore.	7,250,000	AKKSHI	2026–2028
	1.2.3 Përqindja e studentëve të huaj të doktoraturës ndaj totalit të doktorantëve në vend		M1. Të rritet bashkëpunimi me universitetet e huaja me fokus ndërkombëtarizimin.	A1. Të iniciohet që IAL-të në vend të nënshkruajnë MoU ose marrëveshje të tjera për të ndërkombëtarizuar programet e tyre të studimit me IAL-të rajonale dhe të BE-së. A2. Të validohet numri i MoU ose Marrëveshjeve që janë në fuqi dhe outputi i tyre.	11,500,000 3,600,000	Ministria e Arsimit	2026–2028
1.3 Digjitalizimi	1.3.1 Numri i familjeve që përdorin internet fiks me shpejtësi të paktën 100 Mb/s		M1. Të përmirësohet kuadri ligjor për rrjetet e shpejtësisë së lartë/transpozimi i Rregullores së BE për Infrastrukturën Gigabit (GIA act). M2. Të investohet për mbulimin e zonave të bardha.	A1. Projektligji për ACT-in e infrastrukturës Gigabit (GIA) është përgatitur tashmë dhe është gati për procesin e konsultimit. Ministria kryesore është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Pritet që të ketë lehtësira në lejet për zhvillimin e VHCN dhe heqjen e lidhjes së bakrit dhe të ofrojë vetëm fibra për lidhjen me brez të gjerë që çon në VHCN. Suksesi matet duke i ndihmuar operatorët të zhvillojnë VHCN më të shpejtë me më pak vonesa. (MIE). A1. Zbatimi i Projektit Ekzistues në vazhdim për zonat e bardha në tetë prefektura të Shqipërisë nga 12 në total, i quajtur “Zhvillimi i internetit me brez të gjerë në Zonat e Bardha të Shqipërisë në Shkodër, Kukës, Dibër, Vlorë, Gjirokastrë, Fier, Berat, Korçë”.	Pjesë e kostove administrative/ pagesa mujore e stafit (buxheti i pagave të MIE-s), pasi është transpozim i një <i>aquies</i> të BE-së për rregulloren e GIA-s.	MIE	2026
					Përfutur një Grant nga BE-ja prej afërsisht 3,400,000,000 dhe do të merret edhe një kredi prej afërsisht 7,000,000,000 nga BEI për të mundësuar mbulimin e kostove të CAPEX për këtë projekt.	MIE	2026-2030
	1.3.2 Përqindja e individëve (mosha 16–74) me aftësi digjitale mbi nivelin bazë		M1. Të arrihet certifikimi i 2000 personave në vit përmes kursit Aftësi Digjitale të ofruar nga qendrat publike të formimit profesional.	A1. Hartimi dhe miratimi i Treguesve të Monitorueshëm (KPI) të qendrave publike të formimit profesional A2. Fushata ndërgjegjësimi për rritjen e numrit të regjistrimeve në kursin e aftësisë digjitale. A3. Ndjekja dhe monitorimi vjetor i ecures së regjistrimeve në kursin e aftësisë digjitale të punëkërkuarve të papunë përmes sistemit informatik.	Buxheti vjetor i vitit 2026 është 435,000,000.	AKPA	Q2 2026 2026 Q4 2026
2. Investimet	2.1 Financë dhe mbështetje	2.1.1 Shpenzimet për K&Zh në sektorin qeveritar dhe universitar (si % e PBB)	M1. Rritja e fondit të financimit nga buxheti i shtetit për programet kombëtare (PKKZH, PTI, PD, PIKSH dhe ato ndërkombëtare, të menaxhuara nga AKKSHI.	A1. Analizë mbi rritjen graduale të buxhetit për programet kryesore (PKKZH, PTI, PD, PIKSH); - Vendosja e targeteve vjetore të rritjes së fondeve; - Prioritarizimi i fondeve për projekte me impakt të lartë shkencor dhe ekonomik. A2. Rritja e financimit për pjesëmarrje në programe ndërkombëtare; - Bashkëfinancim për projektet në <i>Horizon Europe</i> dhe iniciativa të	3,875,000,000	AKKSHI	Maksimumi do të arrihet në vitin 2030, sipas parashikimeve të SKSHTI 2023-2030.



				tjera; - Fond për mbulimin e kostove të aplikimit dhe partneriteteve ndërkombëtare. A3. Përmirësimi i mekanizmave të shpërndarjes dhe menaxhimit të fondeve; Thjeshtim i procedurave të aplikimit dhe raportimit; Digjitalizimi i proceseve të menaxhimit të granteve. A4. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin financiar të projekteve; Trajtime për stafin administrativ dhe kërkuesit; Standardizim i procedurave financiare sipas praktikave të BE-së. A5. Advokim dhe ndërgjegjësim për rëndësinë e investimeve në kërkim. Fushata informuese për politikëbërësit dhe publikun. Evidentimi i impaktit ekonomik dhe social të K&Zh.			
	2.2 Investimet e firmave	2.2.3 Shpenzimet e inovacionit për person të punësuar	M1. Vazhdimi i punës metodologjike, duke përdorur të dhënat e CIS 2022 dhe CIS 2024. INSTAT-i ka zhvilluar diskutime të brendshme metodologjike dhe konsultime teknike për të përpunuar indikatorin në formatin EIS.		N/A	INSTAT/MF	2026
	2.3 Investime në Teknologjinë e Informacionit	2.3.2 Përqindja e të punësuarve që janë specialistë në TIK	M1. Të vijohet me zbatimin e programit të Kodimit si një mundësi për të rritur numrin e personave të kualifikuar dhe të punësuar në sektorin e teknologjisë së informacionit.	A1. Miratimi i udhëzuesit nga ministri përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për zbatimin e programit të formimit profesional me mbështetje financiare (VKM nr. 646) në fushën e Programimit A2. Shpallja e thirrjes në APP. A3. Zbatimi i programit përmes qendrave të konfirmuara.	100,000,000	AKPA	Q2 2026 Q2 2026 Q4 2026
3. Aktivitetet inovative	3.1 Inovatorët	3.1.1 Përqindja e NVM-ve që kanë prezantuar produkte të reja ose të përmirësuara për tregun ose për vetë kompaninë.	M1. Të rritet përqindja e buxhetit të dedikuar për aktivitete R&D dhe testim tregu për NVM-të. M2. Të ofrohet asistencë teknike (<i>mentorim, konsulentë</i> dizajni, zhvillim produkti, standardizim dhe certifikim), veçanërisht për NVM-të me kapacitete të kufizuara inovative.	A1. Krijimi i një biblioteke online (<i>knowledge hub</i> mbi proceset e inovacionit) në faqen e AIDA: - guida; - template dhe checklist-e për SME-të. A2. Fushata informuese digjitale “Innovate Your Process” për promovimin e përfitimeve konkrete nga Grant AIDA 2026.	N/A	AIDA	Rritje progresive çdo vit në bazë të projekteve.
					N/A	AIDA	Inicimi në Q4 2026
					N/A	AIDA	Q2 2026
		3.1.2 Përqindja e NVM-ve që kanë futur risi në procese (prodhim, menaxhim, logjistikë, etj.).	M1. Të organizohen trajnime, punëtori dhe fushata informuese për përfitimet e inovacionit në procese.	A1. Organizimi i puntorive Green Innovation Labs të fokusuara në: - optimizimin e proceseve të prodhimit - reduktimin e mbetjeve dhe kostove operative; - adoptimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese. A2. Zhvillimi i një punëtorie mbi “Investment Readiness Scorecards (IRS)” për bizneset dhe <i>startup</i>-et e fokusuar në: - gatishmërinë për të adoptuar inovacion në procese; - identifikimin e boshllëqeve në menaxhim, prodhim dhe logjistikë; - mundësi financimi / instrumente inovacioni (<i>EIC pathway</i>).	1,800,000	AIDA	Q4 2027
			M2. Të ofrohen guida praktike dhe shembuj të suksesshëm për aplikimin	A1. Krijimi i një mekanizmi vetëvlerësimi në faqen e AIDA mbi	800,000	AIDA	Q2 2026
					N/A	AIDA	Q4 2026



			e risive në prodhim, menaxhim dhe logjistikë.	inovacionin në sektorë të ndryshëm që ndihmojnë NVM-të të: - identifikojnë boshllëqet në procese - zgjedhin ndërhyrjet më të përshtatshme			
3.2 Bashkëpunimet	3.2.1 NVM-të që kanë bashkëpunuar për inovacion me biznese ose institucione (si % e NMV)	M1. Rritja e fondit të financimit nga buxheti i shtetit për programin kombëtar PTI (projekte kërkimore inovative dedikuar partneritetit IAL me biznes), PKKZH (projekte shkencore ku IAL mund të bashkëpunojnë me biznese) apo projekte ndërkombëtare (<i>Horizon Europe, EUREKA etj</i>) të menaxhuar nga AKKSHI.	A1. Rritja e buxhetit për programet kombëtare dhe ndërkombëtare me komponent bashkëpunimi.	154,000,000	AKKSHI	Parashikuar në SKSHTI 2023–2030 të realizohen gradualisht, me trend rritës, deri në 2030.	
		M2. Krijimi i skemave novatore për bashkëfinancimin e programeve të inovacionit që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit.	A1. Zbatimi i instrumenteve “challenge-based funding”. Rritja e mbështetjes nëpërmjet financimit për zgjidhjet më inovative nga bashkëpunime IAL–biznes.		AKKSHI		
		M3. Informimi dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat dhe instrumentet e financimit.	A1. Promovimi i pjesëmarrjes në programet kombëtare; - Organizimi i ditëve informuese; - Prezantim i mundësive të financimit.		AKKSHI		
		M4. Promovimi i modeleve të kërkimit shkencor në pjesëmarrjen e projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix model</i>).	A1. Organizimi i forumeve shumëpalëshe për inovacion; Diskutim mbi sfidat dhe mundësitë e bashkëpunimit. Shkëmbim praktikash të mira. A2. Mbështetje për projekte të inovacionit social; Financim për iniciativa që adresojnë nevoja të komunitetit.	4,900,000	AKKSHI		
		M5. Forcimi i kapaciteteve të IAL-ve dhe përfaqësuesve të biznesit për shkrim dhe menaxhim projektsh të përbashkëta.	A1. Përditësimi i udhëzuesve praktikë për programet që mbështesin bashkëpunimin me biznesin.	850,000	AKKSHI		
		M6. Fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të vlerësimit të projekteve të kërkimit shkencor me qëllim përfaqësimin e biznesit në këto struktura.	A1. Përfshirja e ekspertëve me eksperiencë në industri në panelët e vlerësimit. A2. Krijimi i mekanizmave transparentë të vlerësimit. Platformë digjitale për procesin e vlerësimit. <i>Feedback</i> i strukturuar për aplikantët.	3,000,000	AKKSHI		
	3.2.2 Numri i publikimeve të përbashkëta kërkimore midis sektorit publik dhe privat për çdo 1 milion banorë.	M1. Rritja e fondit të financimit nga buxheti i shtetit për programin kombëtar PTI (projekte në partneritet IAL me biznes) të menaxhuar nga AKKSHI.	A1. Rritja e buxhetit për financimin e thirrjeve specifike për publikime të përbashkëta; - Linja financimi për projekte që synojnë publikime në revista të indeksuara me bashkautorësi IAL–biznes; - Kriter i detyrueshëm për përfshirjen e partnerëve industrialë. A2. Vendosja e indikatorëve të detyrueshëm të <i>output-it</i> shkencor; - Target minimal për publikime të përbashkëta në çdo projekt të financuar. A3. Mbështetje për kostot e publikimit dhe përgatitjes së artikujve; - Financim për publikime me impakt të lartë dhe analiza laboratorike.	99,000,000	AKKSHI	2026–2028	
		M2. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë	A1. Forume dhe konferenca të përbashkëta akademi–industrial; Prezantim i rezultateve kërkimore dhe identifikim i bashkëpunimeve;	3,300,000	AKKSHI		



			civile, nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix Model</i>).	Nxirje e publikimeve të përbashkëta pas eventeve.			
			M3. Krijimi i skemave novatore për bashkëfinancimin e programeve të kërkimit shkencor që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale shoqërore.	A1. Zbatimi i skemave “ <i>matching funds</i> ” për projekte kërkimore Bashkëfinancim publik–privat për projekte me potencial publikimi. Angazhim financiar i biznesit si kriter vlerësimi. A2. Krijimi i fondeve për “ <i>industrial research publications</i> ”; Skema të dedikuara për publikime që burojnë nga bashkëpunimi me industrinë. Mbështetje për kërkime të aplikuara. A3. Instrumente “ <i>challenge-based</i> ” për zgjidhje inovative; Financim për projekte që adresojnë sfida konkrete të industrisë; <i>Output</i> i detyrueshëm: publikime dhe produkte inovative. A4. Pilotimi i skemave për doktoratura industriale; Doktorantë të angazhuar në kompani dhe IAL; Publikime të përbashkëta si rezultat i kërkimit.	25,000,000	AKKSHI	
			M4. Monitorimi i botimeve të projekteve të financuara në kuadër të Programit Kombëtar PTI.	A1. Evidentimi dhe përditësimi periodik i të gjitha publikimeve shkencore të prodhuara nga projektet e financuara, duke identifikuar bashkautorësitë ndërmjet institucioneve publike të kërkimit/IAL-ve dhe subjekteve private, si dhe verifikimi i tyre në databaza ndërkombëtare të indeksimit shkencor. A2. Krijimi i mekanizmave të detyrueshëm raportimi nga përfituesit e projekteve PTI mbi publikimet, <i>proceeding papers</i> , patentat dhe produktet e tjera shkencore të realizuara në partneritet publik-privat, i shoqëruar me analiza vjetore të performancës dhe ndikimit të bashkëpunimit shkencë–biznes.	3,000,000	AKKSHI	
3.3 Pasuritë intelektuale	3.3.1 Numri i aplikimeve për patenta ndërkombëtare (PCT) për çdo miliard PBB në PPS	M1. Të bashkëpunohet me universitetet dhe qendrat e kërkimit.	A1. Të trajnohen shpikësit në lidhje me mënyrën e hartimit të një aplikimi për patentë për shpikje (përshkrimi i patentës, pretendimet, abstrakti dhe vizatimet). A2. Të trajnohen shpikësit për të përdorur regjistrat ndërkombëtarë të shpikjeve, në mënyrë për të evituar punën e dyfishtë, si dhe për t’u informuar për arritjet në fushën ku ato janë të interesuar. A3. Të trajnohen aplikantët për patentë në lidhje me rrugët më efikase që duhet të ndjekin për të mbrojtur shpikjet e tyre. A4. Të furnizohen me materiale informuese nga DPPI-ja të këndeve të informacionit për IP-në në universitetet teknike dhe bujqësore. A5. Të përfshihen module të IP në kurrikula. A6. Të ofrohet mbështetje për integrimin e lëndëve të pronësisë industriale në fakultete.	2,000,000	DPPI	2026/2027	



			M2. Të mundësohet shërbimi “IP HELP DESK” në DPPI për patentat.	A1. Të jepet këshillim falas mbi hapat proceduralë për regjistrimin e patentave. A2. Të jepen udhëzime individual për hartimin e aplikimeve për patentë dhe dokumentacion teknik. A3. Të ofrohet orientim drejt tregjeve ndërkombëtare.	1,000,000	DPPI	2026/2027
			M3. Të ofrohen stimuj për aplikantë të rinj, ulje të përkohshme tarifash për studentët, <i>startup</i> -et dhe shpikësit individualë.		N/A	DPPI	2026/2028
			M4. Të promovohen sukseset kombëtare nëpërmjet publikimit të historive të suksesit të shpikësve që kanë marrë patentë dhe të bizneseve që përdorin patenta për shpikje.	A1. Promovimi i tyre në raportin vjetor të DPPI-së, apo në rrjetet sociale të institucionit.	200,000	DPPI	2026/2028
		3.3.2 Numri i aplikimeve për marka tregtare për çdo miliard PBB në PPS	M1. Të informohen dhe ndërgjegjësohen bizneset.	A1. Të organizohen fushata kombëtare informuese dhe ndërgjegjësose sipas grupeve. A2. Të zhvillohen tryeza të rrumbullakëta me bizneset në qytetet kryesore për të shpjeguar rëndësinë dhe të drejtat që burojnë nga regjistrimi i markave tregtare dhe informim për rolin e markave në eksport dhe konkurrueshmëri. A3. Të përdoren rrjetet sociale për informim përmes videove të shkurtra, materialeve mediatike dhe intervistave. A4. Të vendoset një material informues në <i>e-Albania</i> , në lidhje me të drejtat dhe rëndësinë e regjistrimit të markës në momentin e aplikimit për regjistrimin e një biznesi. A5. Të publikohen historitë e suksesit të bizneseve që kanë rritur shitjet përmes markave të regjistruara.	4,000,000	DPPI	2026/2027
				M2. Të forcohen kapacitetet e DPPI për markat tregtare.			
				A1. Të zhvillohen trajnime të specializuara të stafit të DPPI nga WIPO, EUIPO dhe zyrat homologe. A2. Të hartohet udhërrëfyesi i markave për Standardizimin e procesit të ekzaminimit.			
				M3. Të mundësohet shërbimi “IP HELP DESK” i DPPI-së për markat tregtare.			
				A1. Të ofrohet këshillim falas mbi hapat proceduralë për regjistrimin e markave. A2. Të jepen udhëzime individuale për hartimin e aplikimeve për regjistrimin e markës. A3. Të ofrohet orientim drejt tregjeve ndërkombëtare.			
				A1. Të organizohen fushata kombëtare informuese dhe ndërgjegjësose, në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së një disenoje industriale dhe të drejtave që burojnë nga regjistrimi. A2. Të organizohen aktivitete në bizneset me potencial të mundshëm për diseno industriale në qytetet kryesore për të shpjeguar rëndësinë e dizenjove industriale. A3. Të përdoren rrjetet sociale, për informim nëpërmjet videove të shkurtra, materialeve mediatike dhe intervistave. A4. Të publikohen historitë e suksesit të			
		3.3.3 Numri i aplikimeve për dizajne industriale për çdo miliard PBB në PPS	M1. Të informohet dhe ndërgjegjësohet publiku.	A1. Të organizohen fushata kombëtare informuese dhe ndërgjegjësose, në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së një disenoje industriale dhe të drejtave që burojnë nga regjistrimi. A2. Të organizohen aktivitete në bizneset me potencial të mundshëm për diseno industriale në qytetet kryesore për të shpjeguar rëndësinë e dizenjove industriale. A3. Të përdoren rrjetet sociale, për informim nëpërmjet videove të shkurtra, materialeve mediatike dhe intervistave. A4. Të publikohen historitë e suksesit të	4,000,000	DPPI	2026/2027



				bizneseve që kanë rritur shitjet përmes disenjave të regjistruara dhe dizajnit me krijime të mbrojtura.			
			M2. Të forcohen kapacitetet e DPPI-së për dizajne industriale.	A1. Të zhvillohen trajnime të stafit të DPPI nga WIPO, EUIPO dhe zyrat homologe. A2. Të hartohen manuallet e ekzaminimit për standardizimin e procedurave të ekzaminimit.	4,000,000	DPPI	2026/2027
			M3. Të mundësohet shërbimi "IP HELP DESK" i DPPI-së për dizajne industriale.	A1. Të jepet këshillim falas mbi hapat proceduralë për regjistrimin e disenjave. A2. Të ofrohen udhëzime individuale për hartimin e aplikimeve për diseno industriale. A3. Të jepet orientim drejt tregjeve ndërkombëtare.	1,000,000	DPPI	2026/2035
4. Ndikimet	4.2 Ndikimet tregtare	4.2.3 Importet e teknologjisë së lartë nga vendet jashtë BE-së-27	M1. Finalizimi i metodologjisë në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duke përdorur llogaritë kombëtare, statistikë të tregtisë së jashtme dhe të dhënat e BSH-së.		N/A	INSTAT/BSH/ Drejtoria e Përgjithshme të Doganave	2026
	4.3 Produktiviteti i burimeve dhe i punës	4.3.1 Produktiviteti i burimeve	M1. Edukimi dhe informimi	A1. Trajnime për NVM-të për zgjerimin e kapacitetit të zinxhirit lokal të furnizimit dhe tregut të shërbimeve për demonstrimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme (transferimi i teknologjisë, zhvilluesit e projekteve, instalimi, operimi dhe mirëmbajtja, ofruesit e shërbimeve etj.) A2. Zhvillimi i platformave të pjesëmarrjes për promovimin (ndërgjegjësimin), zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël A3. Informimi i institucioneve financiare vendase lidhur me energjinë e rinovueshme	Buxheti i parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Masë e parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	2026 e në vazhdim
							2026 e në vazhdim
							2026 e në vazhdim
		4.3.2 Produktiviteti i CO2 bazuar në prodhim	M1. Reduktimi i përdorimit të burimeve të energjisë	A1. Përdorimi i automjeteve me eficientë energjie A2. Reduktimi i nevojave për lëvizshmërinë dhe distancave me anë të planifikimit të integruar	Buxheti i parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Masë e parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Brenda vitit 2026
			M2. Integrimi i sistemit të transportit të mallrave me rrjetet e BE-së (sistemet e transportit të mallrave të BE-së)		Nuk disponohet buxhet specifik, sipas Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Masë e parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Brenda vitit 2028
			M3. Trajnimi dhe rritja e ndërgjegjësimit	A1. Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore A2. Trajnimi i fermerëve për zbatimin e Kodit të PMB-së	Buxheti i parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Masë e parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	2026 e në vazhdim
			M4. Instalimi i impianteve të thithjes së metanit në vendgrumbullime		Buxheti i parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Masë e parashikuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Nga viti 2026 e në vazhdim brenda vitit 2035



URDHËR

Nr. 519, datë 11.6.2026

**PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM
PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTEVE NË EMËR TË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Z. Sokol Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, që në mungesë dhe me porosi, të zëvendësojë për nënshkrimin e korrespondencave të përditshme shkresore, që janë kompetencë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

2. Gjatë periudhës së zëvendësimit, të shqyrtojë dhe të miratojë çdo akt që kalon nëpërmjet sistemit *e-aktet*, në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

3. Periudha e zëvendësimit është e vlefshme për datën 12.6.2026.

4. Ngarkohet z. Sokol Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Sektori i Arkiv-Protokollit për komunikimin dhe administrimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Llambriola Misto**

URDHËR

Nr. 628, datë 11.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË**

1.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Mehedinj	Cujmir*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj



periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.



8. Urdhri nr. 504, datë 12.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 629, datë 11.6.2026

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 770, DATË 6.8.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS”

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 770, datë 6.8.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Spanjës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 631, datë 12.6.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempelmarsch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*



21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Prignitz	Plattenburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geeste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lenggerich*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*
53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geiselhöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verden	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großknäven*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Verl*
59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leezen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Dötlingen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Domum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempen*
70.	Niedersachsen	Cloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Ostercappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebelta*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardelegen*
75.	Niedersachsen	Emsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donaueschingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wernsdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hamm	Hamm*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*
81.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Weeze*
82.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Goldberg-Mildenitz*
83.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Bützow-Land*
84.	Niedersachsen	Göttingen	Gieboldehausen*
85.	Niedersachsen	Cloppenburg	Essen (Oldenburg)*
86.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow*
87.	Hessen	Gießen	Hungen*
88.	Bayern	Cham	Furth im Wald*
89.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kranenburg*

90.	Sachsen-Anhalt	Jerichower Land	Möckern*
91.	Sachsen	Leipzig	Geithain*
92.	Niedersachsen	Osnabrück	Artland*
93.	Sachsen-Anhalt	Harz	Osterwieck*
94.	Brandenburg	Teltow-Fläming	Trebbin*
95.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Eutin*
96.	Brandenburg	Ostprignitz-Ruppin	Heiligengrabe*
97.	Niedersachsen	Cloppenburg	Barßel*
98.	Nordrhein-Westfalen	Hochsauerlandkreis	Meschede*
99.	Thüringen	Kyffhäuserkreis	Kyffhäuserland*
100.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Seelow*
101.	Niedersachsen	Cloppenburg	Emstek*
102.	Niedersachsen	Leer	Moormerland*
103.	Niedersachsen	Wilhelmshaven	Wilhelmshaven*
104.	Niedersachsen	Schaumburg	Bückeburg*
105.	Sachsen-Anhalt	Börde	Oschersleben (Bode)*
106.	Sachsen	Mittelsachsen	Ostrau*
107.	Brandenburg	Elbe-Elster	Uebigau-Wahrenbrück*
108.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Mecklenburgische Kleinseenplatte*
109.	Bayern	Dachau	Odelhausen*
110.	Bayern	Schwandorf	Oberveichtach*
111.	Bayern	Regensburg	Sünching*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 430, datë 21.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së



Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 632, datë 12.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Đurđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha

kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.



2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të



derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre,

materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 623, datë 10.6.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 633, datë 12.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN
E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Baden-Württemberg	Bodenseekreis	Überlingen*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	Hexental*



Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	Müllheim-Badenweiler*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	St. Peter*
Baden-Württemberg	Enzkreis	Heckengäu*
Baden-Württemberg	Emmendingen	Elzach*
Baden-Württemberg	Karlsruhe	Pfinztal*
Baden-Württemberg	Ortenaukreis	Gengenbach*
Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Raumschaft Triberg*
Baden-Württemberg	Waldshut	Waldshut-Tiengen*
Hessen	Bergstraße	Wald-Michelbach*
Hessen	Fulda	Ehrenberg (Rhön)*
Hessen	Odenwaldkreis	Sensbachtal*
Rheinland-Pfalz	Eifelkreis Bitburg-Prüm	Südeifel*
Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Kalbe (Milde)*
Saarland	Merzig-Wadern	Weiskirchen*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi

identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose



iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 437, datë 23.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

NJOFTIM

Nr. 3073/2, datë 15.6.2026

PËR HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Protokolli për ndalimin e tregtisë së paligjshme në produktet e duhanit”, bërë në Seul, më 12 nëntor 2012, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë më datë 13 gusht 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM

Nr. 161, datë 5.6.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGIJËS ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin e ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/8 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘HEC Polemi’ sh.p.k.”,

konstatoi se:



- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të aplikimit të shoqërisë, të depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005 prot., datë 30.3.2026 dhe dokumentacionit plotësues, të përcjellë me shkresën nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.4.2026, vendosi të fillojë procedurat për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë, si dhe për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC Polemit, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek “HEC Polemi” sh.p.k.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.4.2026 dhe 27.4.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 4.5.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1005/3 prot., datë 7.5.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimet e fillimit të procedurave respektive dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 17, të rregullores së licencimit dhe nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, ERE i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikimin e saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/6 prot., datë 12.5.2026, shoqëria ka kthyer përgjigje, por nuk ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nga ku rezulton se duhet të depozitojë ende: shtojcën 1; qëndrimin e bankës për transferimin e aseteve; miratimin/qëndrimin e organit përkatës përgjegjës, në lidhje me transferimin apo përdorimin e lejes së ujit; të bëjë përditësimet mbi miratimet apo qëndrimet përkatëse mbi çdo dokument tjetër që i nënshtrohet transferimit; qëndrimin e MIE-s; si dhe kontratën e transferimit dhe shkresën drejtuar MIE-s në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin. Në lidhje me depozitimin e këtij dokumentacioni, është vlerësuar dhe përgatitur shkresa përkatëse për shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k.

- Po ashtu, për vendimin e fillimit të procedurave nr. 117/2026, ERE ka njoftuar dhe MIE-n, nëpërmjet shkresës nr. 1005/4 prot., datë 7.5.2026, duke i kërkuar asaj që të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me transferimin e licencës dhe aseteve të shoqërisë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/7 prot., datë 28.5.2026, MIE ka bërë me dije se mbajtësi i miratimit, shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., ka depozituar pranë saj kërkesën për miratimin e ristrukturimit organizativ apo transferimin e aktivitetit, shkresë të cilën shoqëria e ka vënë dhe në dispozicion të ERE-s, në kuadër të aplikimit për transferim. Po ashtu, MIE ka parashtruar se në kontratën e nënshkruar midis palëve, cilësohet se “Për çdo transferim të aksioneve/kapitalit themeltar tek të tretët, mbajtësi i miratimit duhet të marrë pëlqimin paraprak të ministrisë” dhe se kërkesa e shoqërisë është ende në fazë shqyrtimi nga ana e saj.

- Në vijim, ERE ka vlerësuar dhe përgatitur shkresën përkatëse për MIE-n, duke i sjellë në vëmendje se, sikurse njoftuar më herët, ERE ka nisur procedurat për transferimin e licencës dhe transferimin e aseteve të paluajtshme të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. dhe jo për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, por gjithsesi do të mbajë në konsideratë vlerësimin e MIE-s, duke i kërkuar që të depozitojë qëndrimin e saj në lidhje me sa referuar.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Drini Bulqizë ndryshuar, dhe me qëllim për të zhvilluar korrespondencën vijuese me shoqërinë dhe MIE-n dhe depozitimin e informacionit/dokumentacionit përkatës prej tyre, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me transferimin e plotë të licencës dhe transferimin e aseteve paluajtshme të HEC “Polemit”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes mbi transferimin e licencës nr. 577, seria P24, dhënë shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k..

2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të paluajtshme të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

3. Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar brenda 20 (njëzet) ditëve.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 162, datë 5.6.2026

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 68, DATË
8.4.2025, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘RENEW’ SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 817/3 prot., datë

3.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të ERE-s “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Renew” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 68, datë 8.4.2025, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Renew” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 3, të vendimit nr. 68/2025, të ndryshuar me vendimin nr. 269, datë 27.10.2025, përcaktohet se: “shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 11.6.2026”, në pikën 4, përcaktohet se: “Me fillimin e operimit, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE testimin e veprës, si dhe duhet të përditësojë në ERE informacionin mbi strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar.”. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se: “ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4.”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në kuadër të rakordimit të zbatimit të kushteve të vendimit nr. 68/2025, të ndryshuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 817, datë 5.3.2026, shoqëria ka sqaruar se në zbatim të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka bërë njoftimet përkatëse për testimin dhe në përfundim të afatit dhe mungesës së përgjigjes, kanë proceduar me testimin e veprës, si dhe ka depozituar raportin përkatës.

- ERE, me shkresën me nr. 817/1 prot., datë 27.3.2026, i ka kërkuar shoqërisë depozitim të njoftimeve të kryera nga ana e tyre në MIE, si dhe informacion në lidhje me stafin teknik për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, sikurse përcaktuar në pjesën e dytë, të pikës 4 të vendimit të Bordit nr. 68/2025, të ndryshuar.



- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 817/2 prot., datë 8.4.2026, ka dokumentuar shkresën e saj të datës 22.10.2025, me anë të së cilës ka njoftuar MIE-n dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për përfundimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratë, si dhe ka shprehur gatishmërinë për të vijuar me testimin e veprës.

- Nga të dhënat që ERE disponon, në kuadër të raportimeve të Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., shoqëria ka filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike në muajin shkurt 2026, pra brenda afatit të përcaktuar.

- Po ashtu, me këtë shkresë ajo ka depozituar kontratën e shërbimit të datës 16.2.2026, për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të energjisë, kryerjen e monitorimit dhe raportimin për prodhimin e energjisë. Në nenin 2 të kësaj kontrate përcaktohet se kohëzgjatja e kësaj kontratë do të fillojë nga data e firmosjes deri në datën 16.8.2026.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Për gjithë sa më sipër, me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe depozitimit të dokumentacionit përkatës të testimit të veprës brenda afatit, rezulton se këto kushte janë plotësuar nga shoqëria, ndaj duhet të shfuqizohen.

- Po ashtu, duke qenë se kontrata e depozituar nga shoqëria, në lidhje me stafin teknik, ka afat vlefshmërie deri në datën 16.8.2026, vlerësohet që brenda këtij afati shoqëria duhet të depozitojë informacion të përditësuar në lidhjen me stafin e saj teknik, ndaj pika 4, e vendimit nr. 68/2025, i ndryshuar, bëhet: “Brenda datës 16.8.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion të përditësuar mbi stafin teknik.”.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3, të vendimit nr. 68/2025, të ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 5 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të

dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3, e vendimit të Bordit nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar, shfuqizohet;

b) Pika 4, e vendimit të Bordit nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar: ndryshon dhe bëhet:

“4. Brenda datës 16.8.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion të përditësuar mbi stafin teknik.”;

c) Pika 5 ndryshon dhe bëhet:

“5. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

**VENDIM****Nr. 163, datë 5.6.2026****MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 199, DATË 15.8.2025, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË ‘RENEW’ SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ ‘PROCREDIT BANK’ SHA”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1616/1 prot., datë 2.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 199, datë 15.8.2025, ‘Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘Procredit Bank’ sh.a.’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Renew” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 199, datë 15.8.2025, ka miratuar dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sh.a.

- Shoqëria ka plotësuar sa kërkuar në pikën 3, të vendimit nr. 199/2025, si e tillë kjo pikë është shfuqizuar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 264, datë 21.10.2025.

- Në kuadër të kushtit referuar pikës 4 të vendimit, me shkresën e fundit të përcjellë me nr. 1616 prot., datë 18.5.2026, shoqëria sqaron se ka shlyer totalin e financimit të marrë, ndaj ka depozituar deklaratën noteriale të bankës, datë 12.5.2026, me anë të të cilës është dhënë pëlqimi për heqjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë dhe zhbllokimin e tyre nga çdo detyrim që rrjedh nga

kontratat e nënshkruara. Gjithashtu, shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të QKB-së, nga shqyrtimi i të cilit rezulton/evidentohet se në datën 14.5.2026 është pasqyruar deklarata noteriale për heqjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë të vendosura mbi bazën e kontratës nr. 740 rep., nr. 437 kol., datë 19.3.2025.

- Për gjithë sa më sipër, për sa kërkuar nga vetë subjekti, e në rrethanat që arsyen kryesore për të cilën është dhënë ky autorizim ka rënë, si dhe në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësojmë se jemi në rrethanat e shfuqizimit të vendimit nr. 199, datë 15.8.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘Procredit Bank’ sh.a.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 199, datë 15.8.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘Procredit Bank’ sh.a.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k., “Procredit Bank” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 164, datë 5.6.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“INFOTELECOM-ALBSOLAR 4” SHPK
PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË
SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E
DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1344/3 prot., datë 3.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Infotelecom-Albsolar 4’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 13.11.2025.

- Me shkresën nr. 1344 prot., datë 29.4.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 1344/1 prot., datë 11.5.2026, ka njoftuar shoqërinë duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar në këtë aplikim.

- Shoqëria me shkresën nr. 1344/2 prot., datë 22.5.2026, ka depozituar të plotë dokumentacionin e kërkuar.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënie e autorizimit

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose fotokopjoje të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se, përmbajtja në aktet noteriale tregon vlera të cilat çmohen se duhet të jenë konfidenciale dhe si e tillë nuk duhet të bëhen publike pasi cilësohen sekret tregtar.

Në lidhje me sa kërkuar nga ana e shoqërisë, në kuadër të trajtimit me konfidencialitet të dokumentacionit depozituar në kuadër të këtij aplikimi, janë bërë vlerësimet përkatëse nga ana jonë konform ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, ku është klasifikuar dokumentacioni i cili konsiston në trajtim tërësisht konfidencial apo dokumentacion i cili ka



identifikimet përkatëse si konfidenciale, duke zbatuar parimin e kufizimit proporcional (pra, klasifikim vetëm për ato pjesë ku ka bazë ligjore dhe nevojë reale për mbrojtje).

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, do të konsiderohet konfidencial dokumentacioni, sa më poshtë vijon:

- Shkresa e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., datë 29.4.2026 me lëndë: “Kërkesë për dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të ‘Infotelecom-Albsolar 4’ sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj ‘Intesa SanPaolo Bank Albania’ sh.a.” (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial për arsye se përmban informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë).

- Deklarata noteriale me nr. 1431 rep., nr. 458 kol., datë 29.4.2026 (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban informacione personale identifikuese të përfaqësuesve ligjor dhe administratorit të shoqërisë, të tilla si nr. licence, emër, mbiemër, adresën etj.).

- “Kontratë kredie bankare” nr. 1229 rep., nr. 373 kol., datë 7.4.2026 dhe “Kontratë kredie bankare” nr. 1230 rep., nr. 374 kol., datë 7.4.2026 (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial për arsye se përmban të dhëna me natyrë ekonomike/kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/palëve të treta nëse publikohen, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë).

Nga ana tjetër, do të konsiderohet dhe trajtohet si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me karakter deklarativ/informues dhe/ose është e depozituar apo e aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

- Ekstrakti historik të regjistrimit tregtar të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, në rrethanat që është i publikuar dhe i aksesueshëm pranë institucioneve publike kompetente).

- Marrëveshja siguruese e datës 7.4.2026 (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv, për arsye se konsiderohet si dokument me natyrë juridike deklarative dhe lidhet me ndryshimin e ortakut të shoqërisë, informacion i cili reflektohet dhe në regjistrin tregtar (QKB).

- Vendimi i datës 7.4.2026, i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4”

sh.p.k. (ky dokument do të konsiderohet jokonfidencial, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale, pasi konsiderohet si një akt me karakter deklarativ, që lidhet me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë dhe janë dokumente që depozitohen pranë QKB-së)

- Deklarata e administratorit e datës 15.5.2026, ku sqaron se nuk ka një vendim gjykate mbi kuotat e shoqërisë dhe deklaratat e ortakëve të shoqërisë të datës 15.5.2026, mbi vullnetin për të kthyer kuotat në gjendjen e mëparshme në rast të mos marrjes së autorizimit nga ERE (këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, që lidhen me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë. Ato nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare dhe personale).

- Deklarata e lëshuar nga banka e datës 18.5.2026, mbi gatishmërinë e vullnetin për të kthyer palët në gjendjen e mëparshme në rast mosmarrje miratimi nga ana e ERE-s (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshtkrimi i detyrimeve dhe deklaratat mbi statusin e kuotave;

- Pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrimit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa “a” – Ekstrakti historik i regjistrimit tregtar;

- germa “b” – Vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., datë 7.4.2026, me anë të së cilës është shprehur dakordësia mbi vendosjen e kuotave të kësaj shoqërie si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

- germa “c” – Marrëveshjet përkatëse:

- “Kontratën e kredisë” nr. 1229 rep., nr. 373 kol., datë 7.4.2026, nënshkruar midis palëve, që do të shërbejë për financimin e TVSH-së së projektit të parkut fotovoltaiik me kapacitet 35.6 mw.



- “Kontratën e kredisë” nr. 1230 rep., nr. 374 kol., datë 7.4.2026, nënshkruar midis palëve, që do të shërbejë për financimin/rifinancimin deri në 70% të kostove totale të investimit për parkun fotovoltaiik me kapacitet 35.6 mwac ose ripagimi i fondeve për borxhet/të papagueshme ndaj ortakëve/personave të tretë që lidhen me ndërtimin e parkut fotovoltaiik, duke mbajtur raportin midis borxhit me kapitalin, për kostot e projektit (përfshirë TVSH-në) 70% me 30%.

- Pika 3 – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s, për sa i përket pagesave të rregullimit.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8 të rregullores, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, ku të reflektohet ndryshimi vendosja e kolateralit mbi kuotat e saj, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguroese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e

detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (sipas kontratave të kredive nr. 1229 rep., nr. 373 kol., datë 7.4.2026 dhe nr. 1230 rep., nr. 374 kol., datë 7.4.2026).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga marrëveshja për zhvillimin e projektit, nënshkruar në 4.12.2024 apo në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 165, datë 5.6.2026****MBI MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË TREGUESIT E
KRITEREVE STANDARDE TË CILËSISË
SË SHËRBIMIT NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 7, pika 1; 16; 19, germa “h” dhe “j”, dhe nenit 20, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Cilësisë, Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimeve të Shërbimit publik dhe Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 1695/1 prot., datë 1.6.2026, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Kuvendi i Shqipërisë në “Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024”, miratuar në datën 9.10.2025, ka rekomanduar marrjen e masave për rishikimin e rregullave dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit, në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë për konsumatorët e energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, ka miratuar “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndërsa me vendimin nr. 97, datë 7.4.2021, ka miratuar treguesit për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021.

- Në zbatim të detyrimit për raportim, OSSH sh.a. ka përcjellë periodikisht të dhëna mbi standardet e cilësisë së shërbimit dhe performancës së rrjetit të shpërndarjes, nga të cilat rezulton trend përmirësues i treguesve kryesorë të cilësisë së

shërbimit, ndërsa me shkresën nr. 2717/2 prot., datë 12.11.2025, ka bërë me dije edhe pritshmëritë për vijimin e këtij përmirësimi dhe procesin e hartimit të Kodit të Shpërndarjes.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 346, datë 29.12.2025, ka vendosur fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, dhe, me shkresën nr. 2865/8 prot., datë 30.12.2025, ka njoftuar palët e interesit, konkretisht: AAES (Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike), MIE (Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë), ME (Ministrinë e Ekonomisë), Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit, AMK (Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit), DHTI (Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë), AK (Autoritetin e Konkurrencës), AP (Avokatin e Popullit), Shoqatën “Konsumatori në Fokus”, Qendrën “Alert” dhe OSSH sh.a. (Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes), duke u kërkuar komente dhe opinione mbi ndryshimet e propozuara.

- OSSH sh.a., me shkresën nr. 47/2 prot., datë 6.2.2026, protokolluar në ERE me nr. 604 prot., datë 10.2.2026, ka paraqitur propozimin e saj për treguesit e pritshëm të cilësisë për vitet 2026, 2027 dhe 2028, duke u bazuar në parashikimet e realizimit të Planeve të Investimeve dhe Mirëmbajtjes për vitet respektive. Nga shqyrtimi krahasues i propozimeve rezulton se treguesit SAIDI, SAIFI dhe Koha e Nevojshme për Rikthimin e Shërbimit pas Defektit (TM dhe TU), të propozuara nga OSSH sh.a., paraqesin përmirësim krahasuar me ato të propozuara në fillimin e procedurës, për rrjedhojë vlerësohet pranimi i tyre. Për sa i përket treguesit ENS, vlerësohet të mbahen në fuqi vlerat e propozuara në fillimin e procedurës (ENS 2026: 33.318 mwh; ENS 2027: 32.651 mwh; ENS 2028: 31.998 mwh), duke qenë se këto vlera synojnë një performancë më të mirë dhe nxisin operatorin e rrjetit drejt mirëmbajtjes dhe operimit efikas të sistemit të shpërndarjes. Gjithashtu, përveç treguesve të propozuara dhe argumentuar më lart, pjesa tjetër e treguesve të tabelës nr. 1, të aneksit të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë”, mbeten të pandryshuar. Kjo dhe për faktin se këta tregues



derivojnë nga Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes. Me përgatitjen e Kodit të ri të shpërndarjes nga OSSH sh.a. dhe miratimin nga ERE, do të mundësohet dhe rishikimi i këtyre treguesve.

- AMK, në *email*-in e datës 12.1.2026, ka rekomanduar publikimin periodik të treguesve të performancës në mënyrë të kuptueshme për abonentët, përfshirjen e grupeve të gjera të interesit në procesin e konsultimit, si dhe zhvillimin e fushatave sensibilizuese lidhur me arsyet e lëvizjes së çmimeve dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit. Vlerësohet se këto rekomandime janë në parim të drejta dhe do të mbahen në konsideratë, ndërkohë që konstatohet se treguesit publikohen në faqen zyrtare të ERE-s, në seksionin “Buletini Informativ Mjor”; gjithashtu, OSSH sh.a. do të njoftohet për nevojën e publikimit transparent dhe të qartë të këtyre treguesve për konsumatorët. Në mënyrë që të akomodohet ky propozim në rregulloren respektive, publikimet do të shtohen në nenin 8 të rregullores duke shtuar një pikë të veçantë, respektivisht pikën 8.3 dhe për rrjedhojë, do të rrimëtohet monitorimi, mbikëqyrja dhe publikimet.

- AAES-ja, ndër komentet e tjera, ka propozuar plotësimin e pikës 9.3, të nenit 9 të rregullores, duke shtuar parashikimin për kompensimin edhe të disbalancave negative. Vlerësohet se ky propozim plotëson një mungesë në rregullore, pasi dispozita aktuale parashikonte vetëm kompensimin e disbalancave pozitive. Furnizuesit, si palë përgjegjëse për balancim, ekspozohen ndaj kostove që lidhen si me disbalancat pozitive, ashtu edhe me ato negative. Pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e prodhuesve me përparësi në tregun e parregulluar krijon mundësinë për lidhjen e kontratave ndërmjet tyre dhe furnizuesve të licencuar që operojnë në treg. Për shkak të ndërprerjeve në rrjetin ku është i lidhur, prodhuesi mund të gjendet në pamundësi për të prodhuar energji elektrike. Si pasojë, furnizuesi që merr energjinë e këtij prodhuesi mbetet pa sasinë e nevojshme të energjisë për furnizimin e klientëve fundorë dhe ekspozohet ndaj disbalancave negative në tregun e balancimit të energjisë elektrike. Pranimi i propozimit të AAES-së për nenin 9, pika 3 të rregullores plotëson mekanizmin aktual të kompensimit të parashikuar në rregullore, i cili aktualisht mbulon vetëm rastet e disbalancave pozitive, duke përfshirë edhe mekanizmin për kompensimin e disbalancave negative; për rrjedhojë,

propozimi i AAES-së pranohet dhe integrohet në rregullore.

- AAES-ja ka propozuar, gjithashtu, riformulimin e pikës 10.1, të nenit 10 të rregullores, duke qartësuar mekanizmin e kompensimit, sipas të cilit OSSH sh.a. kompenson furnizuesin dhe, më pas, ky i fundit kompenson klientët fundorë në të njëjtën vlerë. Vlerësohet se ky propozim përbën një rregullim të arsyeshëm ligjor të dispozitës dhe nuk bie ndesh me interesin e palëve; gjithashtu, shoqëria OSSH sh.a., e njoftuar me shkresën nr. 2865/7 prot., datë 30.12.2025, nuk ka paraqitur kundërshtime lidhur me këtë propozim.

- Propozimi i AAES-së, lidhur me pikën 10.3, të nenit 10 të rregullores, për të kushtëzuar kompensimin e klientëve fundorë me marrjen paraprake të kompensimit nga OSSH sh.a. ndaj Furnizuesit, është vlerësuar i papranueshëm, pasi do të penalizonte klientin fundor duke e bërë subjekt të pasojave që mund të vijnë nga vonesat apo mosmarrëveshjet ndërmjet OSSH sh.a. dhe Furnizuesit. Për rrjedhojë, paragrafi aktual, i cili parashikon kompensimin e klientit në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, mbetet i pandryshuar, duke marrë në konsideratë edhe afatin 3-ditor të përcaktuar në nenin 8.4, të “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit”.

- Në kuadër të rishikimit të rregullores, konstatohet se kompensimi i klientëve fundorë, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, realizohet përmes marrëdhënies kontraktuale ndërmjet OSSH sh.a. dhe Furnizuesit, të rregulluar nga “Marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, e miratuar nga Bordi i ERE-s; për këtë arsye, pika 10.2, e nenit 10 harmonizohet me këtë akt kontraktual, me qëllim garantimin e qartësisë juridike dhe koherencës rregullatore në zbatimin e mekanizmit të kompensimit.

- Gjithashtu, vlerësohet ndryshimi i paragrafit të fundit, të pikës 7.1, si dhe i pikave 7.3 dhe 7.4, të nenit 7, të rregullores, me qëllim përshtatjen e mekanizmit të rishikimit të treguesve të cilësisë së shërbimit me performancën reale të matur dhe të raportuar të sistemit të shpërndarjes.

- Rregullorja aktuale përmban dispozita që kanë humbur aktualitetin ose janë bërë të papërshtatshme për situatën operationale aktuale, përfshirë nenin 6



dhe pikën 7.2, të nenit 7, të cilat parashikojnë afate, raporte apo kërkesa që nuk korrespondojnë më me zhvillimet e sektorit; për rrjedhojë, vlerësohet shfuqizimi i tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshime në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të

furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 97, datë 7.4.2021.

2. Ndryshimin e aneksit të rregullores në parametrat e reflektuar sipas tabelës së standardeve të cilësisë si vijon:

A. Treguesit e pritshëm të cilësisë së shërbimit për vitet 2026, 2027 dhe 2028:

Treguesit	Njesia	VITET					
		2026		2027		2028	
Energji e pa furnizuar ENS	MWh	33,318		32,651		31,998	
SAIDI	Ore	36.07		35.35		34.64	
SAIFI	Numer	21.72		21.28		20.86	
Koha e nevojeshme per riparimin e sherbimit pas nje defekti ne rrjetin e shperndarjes (TM + TU)	Ore (Total Rrjeti)	1.62		1.61		1.59	
		Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural
TM 35 kV	Ore	1.53	1.94	1.51	1.92	1.5	1.9
TM 20 kV	Ore	1.26	1.59	1.25	1.58	1.24	1.56
TM 6 - 10 kV	Ore	2.29	2.83	2.27	2.81	2.25	2.78
TU 0.4 kV	Ore	0.94	1.1	0.93	1.09	0.93	1.08
Cilësia e Frekuencës (FQ)	• Kufiri normal i operimit: 49.8 deri 50.2 Hz.						
	• Gjate çrregullimeve te sistemit: 48.0 deri 52.0 Hz.						
Cilësia e Tensionit (VQ)	Nominal		I Ulet		I Larte		
	230 V		-10%		5%		
	400 V		-10%		5%		
	6 000 V		-5%		5%		
	10 000 V		-5%		5%		
	20 000 V		-5%		5%		
	35 000 V		-5%		5%		
	110 000 V		-5%		5%		
	Koha e Nevojshme për Kërkesat për Lidhjet e Reja	• Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kW ne TU. • Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 kW ne TU. • Jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 21-50 kW ne TU. • Jo më shumë se 60 ditë pune për fuqi të instaluar 50 100 kW ne TU. • Jo më shumë se 60 ditë pune per lidhje ne TM.					
Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Shpërndarjes	72 ORË						
Koha e Nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së Kërkesës.						
Koha e Nevojshme për tu Përgjigjur Ankesave, që kanë lidhje me matjen.	5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së Ankeses.						
Koha e Nevojshme për të Rilidhur Klienteve të cilëve u është Ndërprerë Energjia	Brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit.						
Zgjidhja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit.	30 ditë kalendarike.						
Përqindja e Klienteve Aktualisht me Matës.	Përqindja e Klienteve Aktualisht me Matës është 100%, e numerit të klientëve.						



3. Treguesit e cilësisë së shërbimit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 97, datë 7.4.2021, që nuk përmenden në tabelën e pikës 2, nuk ndryshojnë.

4. Në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar bëhen ndryshimet si vijon:

- Neni 6 i rregullores, **shfuqizohet**;

- Paragrafi i fundit, i pikës 7.1, të nenit 7, të rregullores, **ndryshon dhe bëhet**: “Nivelet e pritshme të performancës, siç miratuar nga ERE për vitin 2028, do të vihen në zbatim menjëherë dhe do të mbeten në fuqi, deri në rivlerësimin e këtyre standardeve nga ERE në funksion të performancës së matur, raportuar dhe ushtruar.”;

- Pika 7.2, e nenit 7, të rregullores, **shfuqizohet**;

- Pika 7.3, e nenit 7, të rregullores, **ndryshon dhe bëhet**: “OSSH sh.a. ose ERE me iniciativën e saj do të propozojë dhe ERE do të miratojë nivelin e lejuar të rishikuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së matur, raportuar dhe ushtruar.”;

- Pika 7.4, e nenit 7 të rregullores, **ndryshon dhe bëhet**: “Jo më vonë se njëherë në 3 vjet ERE do të rishqyrtojë performancën e arritur gjatë kësaj periudhe, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e shpërndarjes.”;

- Neni 8, i rregullores **ndryshon dhe bëhet** “Monitorimi, mbikëqyrja dhe publikimet”, si dhe shtohet pika 8.3 “OSSH sh.a. është e detyruar të publikojë periodikisht, në mënyrë transparente, të qartë dhe të kuptueshme për abonentët, treguesit e cilësisë dhe performancës së shërbimit të ofruar. OSSH sh.a. do të publikojë në faqen zyrtare të *web-it* treguesit e realizuar të cilësisë së shërbimit çdo tre muaj, ndërsa në muajin janar të vitit pasardhës do të publikojë treguesit vjetorë të cilësisë së shërbimit të realizuar për vitin pararendës”;

- Pika 3, e nenit 9 të rregullores, **ndryshon dhe bëhet**: “Në të gjitha rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara, me përjashtim të ndërprerjeve të shkaktuara ose rezultatit të ekzistencës së forcës madhore, energjia e cila nominohet nga Furnizuesi

por nuk shpërndahet nga OSSH për shkak të ndërprerjes, do të kompensohet nga OSSH, si më poshtë vijon: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t’i paguajë Furnizuesit diferencën pozitive ndërmjet çmimit të kontratës/kontratave (në varësitë të kohëzgjatjes të ndërprerjes që afekton secilën kontratë furnizimi në mënyrë individuale) dhe çmimit të disbalancave pozitive të aplikuara nga OST.”. Në rast kur Furnizuesit i shkaktohen disbalanca negative Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t’i paguajë Furnizuesit diferencën pozitive ndërmjet çmimit të disbalancave negative të aplikuara nga OST dhe çmimit të kontratës/kontratave të furnizimit me klientët fundor (në varësi të kohëzgjatjes së ndërprerjeve që afekton secilën Kontratë Furnizimi në mënyrë individuale).

- Pika 10.2, e nenit 10, të rregullores, **ndryshon dhe bëhet**: “Kompensimi i klientëve fundor të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit”, të miratuar nga Bordi i ERE-s.”.

5. Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Cilësisë Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimit të Shërbimit Publik të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**KËRKESË****Nr. 702/8, datë 16.6.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të qytetit të Vlorës”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 1,650,040 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyzet) lekësh. Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të

Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,650,040 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Ermal Shena**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“RIKUALIFIKIMI URBAN NË ZONËN E TREGUT TË HAPUR TË QYTETIT TË VLORËS”

Pronari		Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim				
Nr	Emër/mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Volum	Faqe	Truall			Vlera totale (lekë)	Shënime
										Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Latif Aqif Xhyheri, Ruzhdi Xhyheri, Selaudin Xhyheri, Shermin Aqif Leskoviku, Shpetime Aqif Bazaj, Shazime Aqif Angoni	8605	53/75	Truall	210	210	0	17	176	198.8	8300	1,650,040	1,650,040	Seksioni E. të saktësohet skica për pronat në nr. rendor 1, 2, 3, 7, 8.
VLERA PARAPRAKE													1,650,040	

KËRKESË

Shtetasja Teuta Cekrezi kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ylli Shullani, me atësi Shefqet dhe amësi Vathe, i datëlindjes 4.9.1973, lindur në Durrës, si dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Teuta Cekrezi



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 130|Datë: 22.06.2026 14:21:30
+02:00|45159ea1-01eb-4098-8d6f-f5ff8837477d

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)